



# NEWS SOT

Themeluar në 26 Tetor 2002  
Çmimi 30 lekë  
E Premte 28 Qershor 2024



**Artur Meçollari:** SPAK do na tregojë të vërtetën për lajthitjet Edi Ramës, nga urdhrat që i dha Engjëll Agaçit dhe Gardës për të mos i dorëzuar dokumentet agjentëve të BKH, te sulmet ndaj prokurorëve për sekuestrimin e Bazës Detare të Limionit dhe notat e fundit pozitive ndaj drejtësisë së re

Page 10

## Edi Rama spastron qeverinë më 20 korrik nga ministrat me dosje në SPAK, gati përmbysja e madhe edhe në nivel drejtorësh, socialistët në ankth, furtunë edhe në grupin parlamentar të PS

Page 5



**Spartak Ngjela: Ja çfarë po përgatit Sali Berisha me protestën e thirrur në 11 korrik, si do të dështojë plani i tij për t'i shpëtuar prangave të SPAK**

Page 3

**Flamur Noka në telashe nga SPAK, hetimi pasuror rrezikon të tronditë pozitën e tij, ja provat që do ta fundosin, juristi Romeo Kara nxjerr prapaskenat e forta**

Page 2

**Arben Malaj: Ja informacionet që duhet të dini për rritjen e pagave më 1 korrik dhe kapacitetet ekonomike që ka sot Shqipëria për të bërë ndryshime të mëdha për të ardhurat e pensionistëve**

Page 8

**Rezoluta për Jasenovacin rrezikon të ardhmen e Malit të Zi, një përgjigje e ashpër pritet nga Kroacia, si fshihet dora e Serbisë pas lëvizjeve të fundit, ja pse miratimi është një "thikë me dy presa" për Podgoricën**

Page 11

**Fjalët e saj kanë peshë në të gjithë Evropën, kush është Kaja Kallas, gruaja që mund të bëhet kryediplomatja e BE, ja pse ajo konsiderohet "skiftere ruse" dhe pse Vladimir Putin e ka "halë në sy"**

Page 12

**Biden dhe Trump "kokë më kokë", debati i parë presidencial mund të "shkundë" garën për Shtëpinë e Bardhë, si mund të ndryshojnë rezultatet e sondazheve brenda natës, ja kur do të jetë përballja e radhës e dy kandidatëve**

Page 13

**Skandalin tek Onkologjiku duhet ta hetojë SPAK, të përfshirë ministra, kreu i KLSH zbulon se ka problematika më të mëdha edhe në spitale të tjera, ja abuzimet galopante të mjekëve me ilaçet, pacientëve të tjerë nuk u jepnin recetat për rimbursim, zbardhet raporti alarmant**

Page 7

**Belinda Balluku përfaqëson krimin e organizuar në qeveri, çon paratë e shtetit tek kompanitë e kriminelëve dhe gjezdis botën me lekët e shqiptarëve, opozita i plas skandalet zv/kryeministres**

Page 6

**Ngrihet drejtoria antikorrupsion për të hetuar administratën, ja rruga që do të ndiqet për të mbledhur informacione për abuzuesit në spitale, Kadastër, Dogana, Tatime e Postë, zbardhen detajet nga vendimi i qeverisë**

Page 4

### KOMENT & ANALIZË

Page 15-17

Nga Dr. Florian FUSHA

Sirena e liqenit të Lurës

Nga Ilmi QAZIMI

A kemi ne idiotë të dobishëm në politikë?!

Nga Gjon BRUÇI

Mafia e shëndetësisë dhe e qeverisë

Nga Tomorr SHASHO

Kur Hipokratit ia ke pa hile

Nga Ilir HUNÇI

Dalldisja shqiptare

### RAJON & BOTË

**Partia e ekstremist të djathtë po "luan me zjarrin" në Gjermani, rikthehen thirrjet famëkeqe të nazistëve, ja kush është politikani që pritet të shkaktojë "tërmet" në zemër të Evropës**

Page 14



Romeo Kara: Sali Berishën dhe klanin e tij e shoh të rrënuar politikisht

# Flamur Noka në telashe nga SPAK, hetimi pasuror rrezikon të tronditë pozitat e tij, ja provat që do ta fundosin, juristi Romeo Kara nxjerr prapaskenat e forta

Juristi i njohur Romeo Kara ka paralajmëruar "ditë të zeza" për ish-ministrin e Brendshëm, Flamur Noka, për të cilin Prokuroria e Posaçme (SPAK) ka nisur hetim pasuror. Në një intervistë për gazetën "SOT", Z.Kara thotë se duke parë numrin e lartë të pronave të Flamur Nokës dhe çmimet e deklaruara që janë mjaft larg nga vlera e tregut, ai do ta ketë shumë të vështirë që të dalë nga ky hetim pa u lagur. Juristi përmend edhe akuzat e lëshuara përpara pak kohësh nga Gazmend Bardhi ndaj tij, pronat e vëna përgjatë kohës kur ishte ne pushtet si sejmën i Berishës. Nga ana tjetër, i pyetur për të ardhmen politike të Sali Berishës, Romeo Kara u shpreh se ajo do t'i përkasë një turpi të pashoq, diskreditimi dhe degradimi total politik, mental dhe moral të tij.

**-Zoti Kara, si e shikon protagonizmin e Flamur Nokës? Duket sikur po e mbron me zell Berishën. Keni një koment?**

Padyshim që Flamur Noka po e mbron me shumë zell Sali Berishën, pasi e vetmja rrugë që ka ndjekur ai dhe shumë të tjerë si ai brenda PD-së, për të bërë karrierë në PD dhe politikë, ka qenë vetëofrimi si ushtarë besnikë të tij, familjes së tij dhe klanit të tij. Jo vetëm brenda PD-së, por edhe në PS, PL e kudo, karriera politike bazuar në vlerat e vërteta dhe meritokracinë ka vdekur pa lindur mirë, duke instaluar puthadorjen si çelësin e saj dhe kushtin kryesor për arritjen e saj. Bjerrja morale e krejt politikës shqiptare dhe sidomos asaj berishiste, ka bere qe maskat te bien dhe liderët të dalin lakuriq, ashtu siç janë të zinj dhe mëkatarë të rrethuar nga ushtarë mediokër që gjithashtu janë bashkëmëkatarë me ta. Noka sigurisht që militon në politikë për llogari të padronit të tij Berisha, por edhe për hallin e tij tashme qe ka lidhur me hetimet pasurore që janë hapur përkundëjt tij. Nuk i kemi harruar akuzat e lëshuara përpara pak kohësh nga Gazmend Bardhi ndaj



tij, pronat e vëna përgjatë kohës kur ishte ne pushtet si sejmën i Berishës. Mjafton ky fakt për t'ia kuptuar hallin berishianit Noka. Për mua është thjesht një ushtar i denjë i liderit më të zi të politikës shqiptare. E meriton plotësisht këtë grade.

**-Ndaj Nokës, SPAK ka nisur hetimet referuara nje kallëzimi të bërë nga Idajet Beqiri. Mendoni se do ketë telashe, ndërkohë që zoti Noka thotë jam i pastër?**

Këtë gjë do ta thotë më mirë hetimi pasuror, por në perceptimin tim, duke parë numrin e lartë të pronave dhe çmimet e deklaruara që janë mjaft larg nga vlera e tregut, mendoj që ai do ta ketë shumë të vështirë që të dalë nga ky hetim pa u lagur. Kur fillon hetimi dhe flet drejtësia, retoriken nuk e merr me parasysh askush. Shpresoj që hetimi pasuror te behet sa me i sakte, duke përfshirë edhe shpenzimet e përditshme të cilat do te kenë një rol shume domethënës kur te behet me pas justifikimi i pagesave te kredive bankare. Ajo qe unë dua të theksoj është qe: për faqen e tyre të zezë, ky popull është varfëruar dhe shpërfytyruar, ndërkohë që politikanët pushtetarë pasurohet përtej imagjinatës. Këtë e kam për të gjithë pa përjashtim përfshirë këtu edhe ushtarin Noka.

**-Pati debate për mandatin e Berishës, duke qenë se prej 20 dhjetorit të vitit që shkoi ai nuk ka shkuar në Parlament. Keni një koment pse Lin-**

**dita Nikolla nuk ia dogji mandatin?**

Ligji ka vend shumë për interpretim në këtë pikë. Sidoqoftë, ai duhet të shijojë një dalje të merituar nga politika, me turp dhe diskretituese, nëpërmjet një ndëshkimi shembullor nga drejtësia, i zhveshur nga të gjitha pasuritë që iu ka grabitur shqiptarëve, duke u bërë një shembull dekurajues për zullumçarët dhe motivues për të gjithë shqiptarët e ndershëm.

**-Kush është e ardhmja e Sali Berishës?**

Jam plotësisht i sigurt se, e ardhmja e tij do t'i përkasë një turpi të pashoq, diskreditimi dhe degradimi total politik, mental dhe moral të tij. Ai tashmë e ka vulosur pakthim të ardhmen e tij e cila po lexohet qartë jo vetëm nga ne, por edhe nga vetë ai. E shoh të rrënuar politikisht atë dhe klanin e tij, pavarësisht aksioneve destabilizuese që iniciojnë herë pas here, të zhveshur nga çdo risi apo retorikë normale politike, të shqetësuar më shumë për të kaluarën e tyre se për të ardhmen dhe të ushqyer me shpresën e vetme, që shpëtimi i tyre qëndron vetëm tek destabilizimi i Shqipërisë. Të ardhme më të katranosur se Salziu, pak kush do të ketë në Shqipëri, sidomos nëse marrim parasysh, që ajo do të përfshijë padyshim edhe familjen e tij, tashmë të certifikuar nga USA dhe UK si armiq te demokracisë dhe shtetit ligjor.

Intervistoi: Rigels SELIMAN

## SPAK nis zyrtarisht hetimi pasuror për Flamur Nokën dhe familjen e tij

SPAK, pak javë më parë nisi hetim pasuror për Flamur Nokën dhe familjen e tij. Në objektin e hetimit përfshihen hetimi dhe verifikimi i gjithë transaksioneve financiare në emër të tij gruas dhe dy fëmijëve. Hetimi shtrihet në gjithë sistemin bankar të Shqipërisë, dhe në gjithë zyrat noteriale të vendit, për të parë dhe verifikuar shitjet, blerje pronash apo akt marrëveshje të tjera të tij apo familjarëve me të tretë. Mësohet se hetimi është pjesë e një procedimi penal regjistruar në SPAK, i cili ka të nevojshëm të plotësohet edhe me verifikimin e pasurisë së Flamur Nokës. Në listën e hetimit është Flamur Noka dhe familjarët e tij. Noka. Akuzat për abuzim me pushtetin për Nokën kanë qenë publike në shtyp. Hetimet e SPAK janë përqendruar në vitin 2008, kur Flamur Noka ishte Drejtor i Bordit të Entit Kombëtar të Banesave, i dha katër banesa nga fondi i të pastrehëve në qytetin e Sarandës familjarëve të tij, dy vëllezërve që jetonin në Belgjikë, gruas së vëllait dhe motrës që jeton në Kamëz. Ata i gëzojnë ende dhe sot të katër apartamentet e destinuara për të pastrehë në Sarandë. Konflikti i interesit është i pastër, pasi Noka ishte Kryetar i Bordit të Entit Kombëtar të Banesave Pra, Flamur Noka ka dhënë 4 apartament për familjarët e tij, dy për vëllezërit emigrantë, një për nusen e njërit prej tyre, dhe një tjetër për të motrën. Një histori tërësisht e dyshimtë lidhet me apartamentin që ka përfituar tek diga e Liqenit që për shumë kohë ka qenë pallati më i shtrenjtë në Tiranë. Formalisht Noka shet një apartament 83 m<sup>2</sup>, kati 8, me vlerë 180 mijë euro dhe "blen" një apartament, në një zonë më të shtrenjtë, te diga e Liqenit, 190 m<sup>2</sup>, për 151 mijë euro. Flamur Noka blen garazh me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>, me vlerë 22 400 euro. Në deklaratën e vitit 2013, Flamur Noka nuk e deklaroi burimin e të ardhurave për blerjen e garazhit. Realisht shtëpia e Mulit te Liqeni, bashkë me garazhin, kushton rreth 1 milionë euro. Historia e pallatit tek liqeni lidhet direkt me gjobë shtetërore ndaj pronarit. Me ardhjen e Berishës në pushtet pallati u bllokua dhe u deklarua se nuk do të lejohet të ndërtohet kurrë. Pas negociatave me një ndërtes tjetër ndërmjetës i afërt me Nokën dhe Shkëlzen Berishën, leja u ridha dhe Shkëlzen Berisha përfundoi me apartament që e përdor për zyrë në këtë pallat dhe Noka me apartament banimi. SPAK dyshohet se po verifikon hyrje daljet dhe pagesat e administrimit. Noka po ashtu për gati 15 vite ka pasur vilë në Gjirin e Lalzit të cilin e shiti dy vite më parë pas akuzave të Gazmend Bardhit. Gazmend Bardhi e ka akuzuar atë me emër dhe me shifër. Po ashtu po hetohet roli i tij si ministër i brendshëm në shtyrjen e një afati të një koncesioni shtetëror në mënyrë jotransparente dhe përfitimet prej tij.

## Gonzato: Reforma në Drejtësi, po jep rezultate konkrete për Shqipërinë

"Reformat nuk kanë të bëjnë thjesht me ligjet – ato kanë të bëjnë me njerëzit dhe me ndryshimin e mentalitetit", u shpreh dje ambasadori i Bashkimit Evropian në Tiranë, Silvio Gonzato, gjatë ceremonisë së diplomimit të studentëve të Shkollës së Magjistraturës. "Me reformën në drejtësi, që tashmë po jep rezultate

konkrete për Shqipërinë, kontributi i tyre tani është thelbësor për pakthyeshmërinë dhe suksesin e saj të vazhdueshëm. Doja shumë të isha sot me të diplomuarit e Shkollës së Magjistraturës, pasi ata përfaqësojnë të ardhmen dhe janë fytyra e sistemit të ri shqiptar të drejtësisë që doli nga reforma e 2016-ës. Arritja e tyre më e

madhe do të jetë t'ua dëshmojnë atyre që ende kanë dyshime se drejtësia shqiptare sot është vërtet e pavarur, e shërbyer nga gjyqtarë dhe prokurorë që mishërojnë nivelet më të larta të integritetit. Kjo do të kërkojë aftësitë e tyre më të mira profesionale dhe njerëzore. Ne jemi krah jush", deklaroi ambasadori i BE-së, Silvio Gonzato.

Avokati: Zgjedhjet e lira në Shqipëri i garanton një pushtet gjyqësor i fuqishëm dhe i pavarur

# Spartak Ngjela: Ja çfarë po përgatit Sali Berisha me protestën e thirrur në 11 korrik, si do të dështojë plani i tij për t'i shpëtuar prangave të SPAK

Rigels SELIMAN

**N**e të gjithë historinë e tranzicionit shqiptar, politikani që i ka vënë flakën vendit sa herë ka patur hallin e vet ka qenë dhe mbetet ish-kryeministri Sali Berisha. Ai, në çdo rast që e ka parë punën pisk, është ngritur dhe ka djegur Shqipërinë për të shpëtuar veten. E ka bërë për të mbrojtur apo marrë pushtet deri dje, po e bën për t'i ikur drejtësisë sot duke kërkuar një 97 të dytë pasi po e ndjen rrezikun e burgut. Por për avokatin e njohur Spartak Ngjela këtë herë plani i tij do të dështojë. Ai thotë se në protestën e 11 korrikut që ka thirrur Berisha asnjë gjë nuk do të ndodhë, edhe pse këtë herë ai këtë protestë sipas tij nuk e bën për të ardhur në pushtet, por për t'i shpëtuar procesit penal. Nga ana tjetër, Ngjela ka folur në një studio televizive edhe për vendimin e Konferencës së Kryetarëve që ka gjykuar se nuk do të kërkohej heqja e mandatit të Berishës. Sipas Ngjelës ky ishte një vendim i drejtë, pasi ishte brenda ligjit, pasi Berisha po mungonte me arsye. Po ashtu, avokati tha se qeveria teknike që kërkon opozita për garantimin e zgjedhjeve të lira është një kërkesë që nuk funksionon dhe nëse realizohet dhe pranohet nga kryeministri Edi Rama.



**-Avokat Ngjela. Konferenca e Kryetarëve ka gjykuar që nuk do të kërkohej heqja e mandatit të Berishës, çfarë është kjo gjë për ju?**

Ishte brenda ligjit heqja e mandatit. Nuk e lë Kushtetuta dhe nuk e kap ai ligj sepse duhet parë arsye por Berisha e ka arsyen, e ka ndaluar shteti dhe është në proces penal. Kur je i sëmurë ose kur je në proces penal, vazhdon pa problem.

**-Enkelejd Alibeaj po fliste për krijimin e një force të re politike që mesa duket kjo gjë është vendosur dhe kërkesën për të mbledhur aleatë, sidomos parti të reja dhe parti elektorale. Keni patur komunikim kohët e fundit për këtë meqenëse e keni patur**

**një bisedë më herët?**

Në këto momente nuk jam në bisedime e të shohim ca do bëhet e nuk flasim dot para kohe.

**-Nga ana tjetër, Partia Demokratike, Sali Berisha kanë dalë me një projekt rezolutë përmes së cilës kërkojnë bashkimin e të gjithë opozitës dhe përmes së cilës kërkojnë gjithashtu krimin e një qeverie teknike për të garantuar zgjedhje të lira dhe të ndershme dhe bashkë me to kërkojnë edhe votën e diasporës. Këto janë elementët për zgjedhje të lira, në gjykimin tuaj mund të funksionojë?**

Pjesa e parë që thotë Alibeaj nuk ka vlerë politike, pjesa e dytë që thotë për votimin e dias-

porës, aty ka të drejtë, ajo duhet bërë se është fjalë e Kushtetutës. Mos lejimi të votojnë shtetasit shqiptar që janë në perëndim e duke menduar që të kthehen e të vijnë të gjithë këtu në një kohë që bota e ka zgjidhur me ligj brenda shtetit që e kërkon, ndaj është gabim i rëndë dhe shkelje e kushtetutës. Do ta marrë apo jo përsipër mazhoranca, varet nga ajo por në qoftë se nuk e merr në një kohë që është ngritur si çështje. Në një kohë që është ngritur për çështje, ato bëjnë shkelje të Kushtetutës e deri në vepër penale mazhoranca. Por duke u nisur nga problemi që janë mazhorancë dhe kanë të drejtën në Parlament, nuk mund të flasim se çfarë mund të ndodhë më pas. Dëmtohet elektoralisht opinioni publik shqiptar.

**-Opozitat në Shqipëri, e sidomos opozita e djathtë gjithmonë para zgjedhjeve ka kërkuar një qeveri teknike që garanton zgjedhje të lira dhe të ndershme, ku merret dhe shembulli i Maqedonisë së Veriut. Sa garanton dhe çfarë ndryshon për ju?**

Asgjë, është bërë këtu njëherë dhe asnjë nuk është bërë. Nuk është atje në Maqedoni por te Komisioni i Zgjedhjeve dhe kush e ka Policinë e Shtetit e SHISH-in. Ajo mund ta bëjë këtë e njëkohësisht mban dy poste, dhe ministrin e Brendshëm edhe asgjë nuk bën pasi janë broçkulla. Vota e lirë në Shqipëri vjen si pasojë se të dy krahët kur kanë qenë në pushtet i kanë futur krahët Shqipërisë. Këtë e ndalon vetëm një pushtet gjyqësor i fuqishëm dhe i pavarur.

**-Ka një protestë kombëtare të thirrur nga PD në datë 11 Korrik, besim force, vlerësim masiviteti? Çfarë synon Berisha të arrijë me këtë?**

Deri tani ka qenë zë në shkretëtirë dhe nuk heq dorë nga kjo gjë se ka karakterin e tij mesjetar në politikë. E ka fisnore. Në këto momente nuk e bën për të ardhur në pushtet, nuk e ka politike por e ka t'i shpëtojë procesit penal por nuk i shpëton dot se e ka arrestuar SPAK-u.

**“Ishte brenda ligjit heqja e mandatit. Nuk e lë Kushtetuta dhe nuk e kap ai ligj sepse duhet parë arsye por Berisha e ka arsyen, e ka ndaluar shteti dhe është në proces penal. Kur je i sëmurë ose kur je në proces penal, vazhdon pa problem.”**

## Kreshnik Spahiu: Banda e Onkologjikut është më e rrezikshme se ajo Vis Martinajt, SPAK të akuzojë Ministren e Shëndetësisë për moskryerje të detyrës

Juristi Kreshnik Spahiu tha dje në një intervistë televizive se hetimet për skandalin e zbuluar në spitalin e Onkologjikut duhet të shkojë më lart jo vetëm tek mjekët të cilët zhvatnin pacientët me sëmundje tumorale. Ndjej habi që Prokuroria Speciale nuk ka nisur hetimin për ministren e Shëndetësisë. Nuk flasim me emra. SPAK duhet të fillojë hetimin për ministren e Shëndetësisë që gjatë raportimit të KLSH ka patur dijeni për shkeljen e bërë nga aparatúra për pacientët me kancer. Qoftë ministrja e vjetër dhe e re duhet të jenë në akuzë për moskryerje të detyrës që kanë patur dijeni dhe ka ardhur pasoja. Nen 248 i kodit penal parashikon rastet kur funksionari i lartë me mosveprim me mosangazhimin lejon kryerjen e veprave penale ku kanë përfituar subjektet nën nomenklaturë. Me raportin e KLSH është vënë në dijeni qeveria dhe

dikasteri përkatës nuk ka marrë masë. Ka qenë detyra e ministrisë të merrte masa. Është përgjegjësi penale. SPAK duhet të hetoj ministrat e Shëndetësisë që nuk kanë kryer detyrën. Një institucion i specializuar për kontrollin e ligjshmërisë ka konstatuar shkelje të rënda. E habitshme se si qeveria Rama mban në post ministren nëse ajo ka pasur dijeni. Ndjej keqardhje të madhe kur shikoj klasifikimin e veprës penale që është korrupsioni, nuk është marrje ryshfeti”, tha ai. Më tej, Spahiu e ka quajtur grupin e mjekëve tek Onkologjiku si bandë, madje më të rrezikshme se ajo e Ervis Martinajt. “I gjithë qëllimi është përfitim përmes jetës dhe shëndetit të njeriut. Është vënë në dyshim parimi bazë e drejta për të jetuar. Banda e Onkologjikut është më e rrezikshme se banda e Vis Martinajt. Sepse vriste qytetarë e varfër dhe të dobët. Banda e Vis Martinajt

vriste të pasurit dhe biznesmenët në Shqipëri. Është vepër penale e vrasjes për qëllim përfitimi”, tha ai. Sakaq, Spahiu u ndal edhe tek situata e opozitës, duke komentuar edhe mosheqjen e mandatit të Sali Berishës, që sipas tij është pjesë e marrëveshjes Rama-Berisha. “Kryetarja e kuvendit është spikere. Ka marrë një direktivë politike nga Rama për të përkëdhelur Berishën. Arsyet për këtë, Rama ka interes që përballë të ketë Sali Berishën. Sepse luftën e tij politike e bëjnë ndërkombehtarët dhe s'ka arsye të luftojë Berishën. Edhe ti çojë një sinjal bashkëpunimi. Berisha dhe Rama kanë një armik të përbashkët, SPAK. SPAK është opozita e vërtetë e të dyve, i lë pa gjumë të dy. Gjithë strategjia e tyre të imunizojnë njëri0tjetrin, kanë interesa të përbashkëta ku konvergojnë interesat politike afatgjata të Ramës të përcaktoj qartazi zgjedhjet. Është e trukuar rezultati”, tha ai.

## Juristi Kreshnik Spahiu: Mos shpallja e zgjedhjeve të parakohshme në Himarë, skandal anti-kushtetues

Për juristin Kreshnik Spahiu mosshpallja e zgjedhjeve të parakohshme për bashkinë e Himarës, është një skandal që shkel kushtetutën. Duke folur për Fredi Belerin dhe opozitën, Spahiu tha dje në një studio televizive se protestat e PD-së janë vetëm për të treguar se kush është lideri i opozitës dhe nuk ka lidhje me kauzat e qytetarëve. “Ndjej keqardhje që Shqipëria nuk po shpall zgjedhje të parakohshme në Himarë, skandal që lë popullin e Himarës pa përfaqësues. Vlerësoj që çdo parti ka të drejtë të protestoj. PD ka traditë të suksesshme për protesta, por ka qenë kampion në protesta dhe humbëse në zgjedhje. Ka 30 vjet në Shqipëri asnjë qeveri nuk bie nga protestat. Protestat politike nuk kanë çuar në zgjedhje të parakohshme. Janë vetëm konsum i kauzave popullore, për ti djegur ato. Më vjen keq që nuk isha dje para spitalit për të protestuar. Janë kauzat që çojnë në rrëzimin e një regjimi politik. Protestat e 11 korrikut kërkon të vërë vulën që opozitë në Shqipëri është vetëm Sali Berisha. Qëllim për të minuar çdo iniciativë tjetër politike. Mentalitet idiot, që kush nuk është me Berishën, është pro Ramës. Nuk ka një pjesë intelektuale që mendon se këta janë bashkë. Është ndeshje bastesh. Synojnë që përgjithmonë të vënë shishen e qumështit dhe të marrin peng bunkerin opozitar”, nënvizoi Spahiu.

# politikë

## Rama firmos krijimin e DPAK

# Ngrihet drejtoria antikorrupsion për të hetuar administratën, ja rruga që do të ndiqet për të mbledhur informacione për abuzuesit në spitale, Kadastër, Dogana, Tatime e Postë, zbardhen detajet nga vendimi i qeverisë

Rigels SELIMAN

**K**ëshilli i Ministrave miratoi ngritjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, (DPAK) e cila ka për mision të sigurojë parandalimin e goditjen e korrupsionit në institucionet e administratës shtetërore/entet publike/shoqëritë tregtare me kapital shtetëror. DPAK do të kryejë hetime administrative, për rastet e dyshuara si praktika abuzive ose korruptive. Një ndër detyrat e saj është dhe kryerja e hetimit administrativ në kuadër të denoncimeve ose ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimin e punonjësve të institucioneve ku DPAK-ja shtrin aktivitetin, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi thuhet në vendim. Në rastet e hetimeve të thelluara, mund të kërkojë dhe ndihmën e ekspertëve vendas dhe të jashtëm të cilët duhet të ruajnë sekretin hetimor. “ Në rastet e hetimeve të thelluara, për shkak të njohurive të veçanta që kërkon hetimi ose verifikimi i një çështjeje, në grupin e punës së DPAK-së mund të përfshihen edhe ekspertë të administratës shtetërore dhe/ose ekspertë të jashtëm. Në rastin kur është e nevojshme përfshirja e ekspertëve nga administrata shtetërore, drejtori i Përgjithshëm i DPAK-së paraqet kërkesën pranë institucionit që mbulon fushën përkatëse për vendosjen në dispozicion të ekspertit/ekspertëve, i cili/të cilët kanë kualifikimet e



cilësitë e kërkuara për kryerjen e hetimeve. Titullarët e institucioneve duhet të vendosin në dispozicion ekspertë nga administrata shtetërore, të cilët përmbushin kriteret përkatëse. Ekspertët e administratës shtetërore e ushtrojnë veprimtarinë e tyre nën drejtimin e drejtuesit të grupit të hetimit të thelluar, sipas përcaktimeve të urdhrit të drejtorit të Përgjithshëm të DPAK-së dhe brenda afatit të përcaktuar në këtë urdhër. Ekspertët e administratës shtetërore dhe ekspertët e jashtëm, të angazhuar në hetime të thelluara sipas përcaktimeve të këtij kreu, nënshkruajnë deklaratë konfidencialiteti”, thuhet në pikat 10, 11, 12, 13 të këtij vendimi.

### Funksioni

Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit (DPAK) do të ketë për funksion mbledhjen e informacionit për veprimtaritë korruptive dhe praktikën abuzive nga burime të ndryshme dhe të kryejë hetime administrative, për rastet e dyshuara si praktika abuzive ose korruptive. Në çdo

rast, në përfundim të hetimit hartohet raport përfundimtar, i cili i propozohet për miratim drejtorit të Përgjithshëm të DPAK-së. Në rastet e dyshimit të arsyetueshëm dhe administrimit të provave për praktikën korruptive, kjo drejtori paraqet kallzim penal në prokurori.

### DPAK do jetë në varësi të kryeministrit

Struktura dhe organika e DPAK-së miratohen me urdhër të Kryeministrit. Drejtori do të jetë në varësi të ministrit përgjegjës për antikorrupsionin, në rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit. Përgjigjet para tij dhe kryeministrit. Drejtori i Përgjithshëm emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit. Ndër kriteret e përzgjedhjes së kandidatit për drejtor është dhe fakti që duhet të jetë shtetas shqiptar s’duhet të jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake të paktën 5 (pesë) vitet e fundit para emërimit dhe as të ketë konflikt interesi.

### Ja 26 institucionet që do kenë koordinator kundër korrupsionit

1. Operatori i Blerjeve të Përqendruara, sh.a;
2. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore;
3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
4. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura;
5. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural;
6. Agjencia Shtetërore e Kadashtës, në nivel qendror dhe në drejtoritë vendore, sipas përcaktimit të DPAK-së;
7. Agjencia e Trajtimin të Pronave;
8. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit;
9. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
10. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
11. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar;
12. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;
13. Instituti i Shëndetit Publik;
14. Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit;
15. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore;
16. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor;
17. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial;
18. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë;
19. Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor;
20. Posta Shqiptare;
21. Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”;
22. Spitali Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”;
23. Spitali Universitar i Traumës;
24. Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Glliozheni”;
25. Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës “Shefqet Ndroqi”;
26. Shërbimi Social Shtetëror.

### Koordinator në çdo institucion

Vendimi parashikon po ashtu edhe institucionet, entet publike dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror, ku krijohet pozicioni i koordinatorit kundër korrupsionit. Janë 26 institucione mes tyre dhe spitale, agjenci e drejtori. Kjo strukturë do të shtrijë veprimtarinë në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe ka një sërë kompetencash. DPAK-ja bashkëpunon me Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje dhe çdo platformë tjetër të ankesave publike on-line. Po ashtu, bashkëpunon e merr informacion nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe kryen të gjithë procedurën e hetimit administrativ të për-

caktuar në këtë vendim për raste korruptive.

### Sa do paguhet?

Përveç pagës mujore, nëpunësit e DPAK-së përfitojnë një shtesë për natyrë të veçantë pune, në masën:

- 65 000 lekë në muaj, në pozicionet “drejtor i përgjithshëm”, si dhe “drejtor drejtorie”, “përgjegjës sektori” e “specialist”, në drejtorinë që mbulon hetimin, analizën dhe monitorimin e zbatimit të rekomandimeve;

- 40 000 lekë në muaj, në pozicionet “drejtor drejtorie”, “përgjegjës sektori” dhe “specialist”, në drejtorinë që mbulon zbatimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

## Ministri Balla në DASH takim me Robinson: Prioritet, lufta ndaj krimit të organizuar e narkotikëve

Ministri i Brendshëm Taulant Balla, është takuar dje në Departamentin Amerikan të Shtetit në Washington me ndihmësekretarin e Shtetit, Todd D. Robinson. Në një postim në rrjetet sociale, ministri Balla ndau detaje nga takimi, ndërsa theksoi se prioriteti i bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe SHBA është lufta ndaj krimit të organizuar dhe narkotikëve. Balla po ashtu theksoi dhe bashkëpunimin e shkëlqyer me agjencitë ligjzbatuese dhe programet e asistencës amerikane, përfshirë

DEA, INL dhe ICITAP. “Mirëpresim mbështetjen amerikane në forcimin e kapaciteteve dhe shkëmbimin e eksperiencave mes Akademisë së Sigurisë dhe shkollave të policisë në SHBA”, shkroi Balla. Ai theksoi se “lufta kundër krimit të organizuar, prodhimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike mbetet një prioritet kryesor”. Sipas tij, “goditjet kundër grupeve kriminale po intensifikohen çdo ditë falë hetimeve komplekse në bashkëpunim me SPAK dhe prokuroritë e juridiksionit të

përgjithshëm”. Balla thekson se përpjekjet për përmirësimin e rezultateve në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore do të intensifikohen, në kuadër të Mekanizmit Kombëtar të Referimit. Ministri i Brendshëm mbyll njoftimin duke theksuar se Shqipëria dhe SHBA janë pjesë e Koalicionit Global kundër kërcënimit të Drogave Sintetike, duke koordinuar masa konkrete kundër prodhimit, trafikimit dhe shitjes së tyre tek të rinjtë dhe përdoruesit e tjerë.

## SHBA, Balla takon Moolenaar: Vëmendje të shtuar keqpërdorimit të rrjeteve sociale

Ekspertiza amerikane do të ndihmojë për kontrollin më efikas të internetit tek të rinjtë dhe rritjen e sigurisë kibernetike në Shqipëri. Ministri i Brendshëm, Taulant Balla u takua në Uashington, me kryetarin e Komisionit Special në Kongresin amerikan, John Moolenaar. Balla zhvilloi një bisedë, që e konsideroi të frytshme, mbi sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e përdoruesve të internetit dhe rrjeteve sociale nga dhuna online. “Ne i kushtojmë një vëmendje të shtuar keqpërdorimit të rrjeteve sociale për veprimtari apo promovim të sjelljeve të paligjshme.

Është i domosdoshëm verifikimi i moshës dhe identitetit të përdoruesve, monitorimit të kohës së qëndrimit, monitorimit prindëror me qëllim shmangien e varësisë tek fëmijët dhe adoleshentët”, nënvizoi ministri i Brendshëm pas takimit me zyrtarin amerikan. Kongresi Amerikan dhe Parlamenti Europian kanë kërkuar monitorim të detajuar gjatë periudhave zgjedhore, për të shmangur dezinformimin dhe ndërhyrjet në proceset zgjedhore. Kongresmeni Moolenaar është një zyrtar i njohur dhe mik i rëndësishëm i diasporës shqiptare në Miçigan.

# politikë

www.sot.com.al

## Lulzim Basha: Rama-Berisha në pazar për falje pushteti dhe kapjen e SPAK, do bëjmë rekurs në Gjykatën e Lartë, alternativa jonë do jetë në zgjedhje

Drejtesi i demokratëve euroatlantik, Lulzim Basha teksa ishte i ftuar dje në një studio televizive zbuloi vendimi i 11 qershorit i Gjykatës së Apelit do të çohet në Gjykatën e Lartë përmes një rekursi. Ai theksoi se po pret zbardhjen e vendimit të Apelit për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë. Basha tha se në këtë vend nuk mund të shndërrohet në normë padrejtësi. "Nuk pati gjykim themeli në Apel, sikundër udhëzonte Gjykata e Lartë. Me çështjen do të merren

juristët, ne nuk harxhojmë asnjë minutë kohë me këtë debat shterpë", tha Basha, duke shtuar se forca jonë është Partia Demokratike e Shqipërisë, demokratët euroatlantikë. Më tej Basha tha se ky vendim është në vijim të pazareve mes Sali Berishës dhe Edi Ramës, aku të parit i jepet një vulë, ndërsa të dytit i falet pushteti edhe për 4 vjet. Madje Basha paralajmëroi se ky pazar do të vijojë dhe shqiptarët do të përballen me gjëma si pasojë e këtij pазari.

"Amnistia e votuar nga disa deputetë të PD-së për të liruar zyrtarë të dënuar nga SPAK për korrupsion është fakt dhe nuk është akuzë", u shpreh Basha. Ndërkohë ai se ka bashkuar votat me socialistët për reformën në drejtësi, ndërsa u shpreh se nuk mund të krahasohet bashkimi i votave për rritjen e pagave të atyre që pastrojnë sistemin e drejtësisë nga të korrupuarit dhe bashkimin e votave për të liruar nga burgu të korrupuarit e Edi Ramës. "Ky është

fakt i bashkëpunimit mes Ramës dhe Berishës", tha Basha Nga ana tjetër, Basha tha se Sali Berisha i ka dorëzuar zgjedhjet e 2025 te Edi Rama. Ai u shpreh se Berisha ka mashtruar shqiptarët me lugën bosh, ndërsa theksoi se ne kemi strukturat tona në të gjithë Shqipërinë. Basha u shpreh se ai përfaqëson Partinë Demokratike, demokratët euroatlantikë, duke shtuar se rekursit për vulën dhe logon e PD-së do ti shkohet deri në fund. "Sali Berisha do e çojë

PD në 2025 për dhjamë qeni, do i fusë krahun demokratëve. Do e ndjekim çështjen e logos së PD-së deri në Strasburg. Ne do të jemi në 2025 një alternativë për shqiptarët, me apo pa logo. Pazarit i Berishës ka nisur me bashkimin e votave për lirin nga burgu të të korrupuarve të Edi Ramës, me prishjen e komisionit për reformën zgjedhore, vijoi me vulën, dhe objektivi kryesor i të dyve është SPAK. E kanë gati", nënvizoi Basha.

Pas Spiropalit edhe Klosi flet për rinovim të grupit parlamentar

## Edi Rama spastron qeverinë më 20 korrik nga ministrat me dosje në SPAK, gati përmbysja e madhe edhe në nivel drejtorësh, socialistët në ankth, furtunë edhe në grupin parlamentar

Rigels SELIMAN

Numerimi mbrapsht për ndryshime në qeveri, drejtorësh të lartë dhe madje edhe në grupin parlamentar të Partisë Socialiste duket se ka nisur. Ishte vetë kryeministri Edi Rama, ai i cili pak ditë më parë në Asambleshën e PS të mbajtur online, zbuloi se do të ndryshohet skema e përcaktimit të listës së kandidatëve për deputetë në zgjedhjet e 2025. Kjo do të thotë se shumë nga deputetët aktualë mund të largohen, ndërkohë që vendin e sigurtë nuk e kanë as ministrat, çka tregon se ujërat brenda PS janë trazuar. Shumë po arrestohen, por ka dhe të pakënaqur. Rama po mundohet t'i largojë nga vetja ata që i hanë kumbulla, por kjo nuk e ka ndihmuar. Kështu që për të çuar përpara planin e tij të spastrimit, Rama ka menduar që të hedhë piketat në mbledhjen e Kongresit të Partisë Socialiste më 20 korrik. Gazeta "SOT" ka mësuar se shefi i qeverisë është shumë i pakënaqur nga ministrat,



deputetët dhe drejtorët e rëndësishëm, të cilëve pritet t'ua japë goditjen muajin tjetër. Mësohet se ky vendim ka shkaktuar ankth në radhët e socialistëve dhe sidomos në radhët e zyrtarëve të lartë. Jo thjesht për mënyrën okulte me të cilën Rama i merr vendimet e tij për zëvendësimet, as për humbjen e privilegjeve që vijnë bashkë me postin ministror, por edhe se të jesh një "ish" i qeverisë e Ramës të bën automatikisht ushqim

për statistikën e drejtësisë së re. Megjithatë mbetet të shihet të shtunën e 20 korrikut, veçse një gjë është e sigurtë që ciklonit dhe furtunës nuk ka për t'i shpëtuar askush, sidomos ata zyrtarë (ministra, deputetë e drejtorë të lartë) që kanë llogari të hapura me drejtësinë dhe po hetohen nga Prokuroria e Posaçme (SPAK) si të përfshirë në afëra korruptive dhe kriminale.

### Paralajmërimi

Por paralajmërimin për ndryshime të forta në radhët e ministrave dhe grupit parlamentar i kanë dhënë këtë javë edhe ministrja e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Elisa Spiropali dhe sekretari i Përgjithshëm i Partisë Socialiste, Blendi Klosi. Ky i fundit teksa foli dje në një media, konfirmoi se PS do të ketë rinovime para zgjedhjeve parlamentare që garon për mandat të katërt. Zoti Klosi theksoi se Partia Socialiste në 32 vite ka treguar se i jep rëndësi harmonizimit të brezave, por edhe mbajtjes së gjeneratave. "Ajo që PS ka treguar në gjithë këto 32 vite jetë të saj, është

harmonizimi i brezave dhe mbajtja e gjeneratave. Që nga asambleja e dhe themeluesit në parti, kontributor të rinj të kësaj partie. Kjo ka qenë filozofia jonë në 33 vite. Nëse kemi një meritë është të qenurit të gjithë bashkë edhe pse brezat zëvendësojnë njëri tjetrin. PS ia doli që me votimin 1 anëtar një votë në trupën e delegatë të kongresit, 3/4 të ishin të rinj. Pra prurja e elementëve të rinj, nuk është risi. Sa i përket listës së deputetëve do të jetë proces me propozime nga e gjithë struktura, me një strukturë që do të kërkojë fitoren e mandatit të katërt që është objektivi ynë madhor", deklaroi Klosi. Ndërkohë një paralajmërim i kësaj natyre është bërë pak ditë më parë edhe nga ministrja për Parlamentin, Elisa Spiropali. Ajo u shpreh se treçereku i qeverisë apo Parlamentit mund të mos jetë në këto pozita pas zgjedhjeve të vitit 2025. Përgjigjja e saj erdhi pas pyetjes se pse u ngritën tani dy komisionet e anti korrupsionit dhe dezinformimit, kur dihet që është sesioni i fundit par-

lamentar? "Nuk është çështje kohe, është çështje objektivi se ku do të arrish. Ky sesion mbaron shumë shpejt dhe nis edhe sesioni i fundit për këtë legjislaturë. Gjykuam që duhet tani. Komisioni për Mirëqeverisjen është një komision që ka për synim që të dalë me një plan veprimi. Parlamenti ka gjithë tagrin dhe hapësirën që ia jep Kushtetuta që të mundësojë që si ekzekutivi, institucionet e pavarura dhe ato të krijuara me ligj të raportojnë për disa çështje që janë aty në sytë e të gjithëve: raporti i BE-së me rekomandimet përkatëse. Kjo për ne nuk është çështje individësh apo identikitesh. Unë jam, mund të mos jem në Parlament apo në qeveri. Treçereku i qeverisë apo i Parlamentit është dhe mund të mos jetë në Qeveri apo në Parlament. Ajo që mbetet dhe është e pandryshueshme është dëshira, vullneti dhe puna jonë për të lënë një Shqipëri më të fortë", deklaroi ajo. Pra sinjalet që jep Klosi dhe Spiropali janë se zgjedhjet e 2025 do të jenë me shumë surpriza.

### Nuk u paraqit në Komisionin e TIMS, zbulohet se ku ndodhej drejtoresha e SHISH, Vlora Hyseni

Drejtoresha e Shërbimit Informativ Shtetëror (SHISH), Vlora Hyseni nuk mori pjesë në Komisionin e Posaçëm të TIMS pasi ishte takuar me asistentin e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Scott Bray. Mungesa e saj shkaktoi debat mes anëtarëve të mazhorancës dhe opozitës në seancën e djeshme të komisionit. Përmes një postimi në rrjetet sociale zbulohet se Hyseni zhvilloi një vizitë në selinë qendrore të NATO-s në Bruksel në të cilën realizoi një takim zyrtar me asistentin e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, z. Scott

Bray. Në këtë takim u prekën çështje të rëndësishme lidhur me kontekstin e sigurisë rajonale por edhe tema mbi të ardhmen e nismave të inteligjencës të NATO-s. Hyseni u takua edhe me Drejtoreshën e Intelgjencës Kombëtare, znj. Avril Haines, ku u theksua partneriteti mes SHBA dhe Shqipërisë, si dhe u diskutua lidhur me sfidat e përbashkëta të inteligjencës dhe sigurisë. Gjithashtu, gjatë kësaj vizite, Hyseni ka realizuar disa takime me zyrtarë të lartë në fushën e inteligjencës dhe sigurisë së SHBA.

### Berisha: Edi Rama, Çubrilloviçi i shqiptarëve publikon censusin pasi i ka manipuluar të dhënat nga e para tek e fundit

Kreu i PD, Sali Berisha ka paralajmëruar dje se ditën e nesërme, pra sot, Edi Rama do të publikojë të dhënat e censusit, pasi i ka vonuar për më shumë se 6 muaj. "Të dashur qëndrestare dhe qëndrestarë, misionarë të vërtetë të kauzës së madhe të lirisë, dinjitetit të çdo shqiptari, të atdhetarisë dhe interesit kombëtar. Të dashur qytetarë dhe qytetare, nesër Edi Rama, Çubrilloviçi i shqiptarëve publikon të dhënat e regjistrimit të popullatës pasi ka manipuluar ato nga e para tek

e fundit. Pasi ka shtuar qindra e mijëra qytetarë që nuk janë më në Shqipëri këtë vit, as prej vitesh. Se cili është rezultati i këtij akti, unë dua t'ju informoj ju vetëm kaq se i realizuar me të njëjtën metodikë si kjo e Shqipërisë, Republika e Kosovës i ka publikuar ato brenda ditës që është regjistruar dhe qytetari i fundit në atë vend. Sepse regjistrimi online e bënte të mundur plotësisht këtë. Në vitin 2011, regjistrimi u bë me formularë të mbushur nga punonjësit duke

takuar çdo qytetar. Megjithatë, publikimi i tij nuk mori kurrë më shumë se tre-katër javë. Në Serbi, regjistrimi i popullatës u publikua pas tre javësh. Në Shqipërinë e narkoshtetit të Edvin Drogës, ky regjistrim publikohet pas nëntë muajve. Me këtë histori mashtrimi kërkon Çubrilloviçi të maskojë krimin e tij më të shëmtuar ndaj shqiptarëve, krijimin e kushteve për largimin e tyre masiv nga Shqipëria", deklaroi dje Berisha nga ballkoni i shtëpisë së tij.

# politikë

## Skandali te Onkologjiku, PD kërkon dorëheqjen e 3 ministrave: Janë koka e korrupsionit, kanë qenë në dijeni të aferës

Për skandalin në spitalin "Onkologjik" opozita kërkoj në Kuvend shkarkimin e tre ministrave. Sipas deputetes së Partisë Demokratike Albana Vokshi, ish-ministrja e Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu, ministrja aktuale Albana Koçiu dhe ai i drejtësisë Ulsi Manja kanë qenë në dijeni të abuzimeve në këtë sektor. "Në këtë qeverisje të paktën tre ministra, Koçiu, Manja dhe Manastirliu duhet të ishin

shkarkuar. Kanë qenë në dijeni të skandalit të onkologjikut dhe nuk kanë reaguar. Koka e korrupsionit janë këta tre ministra", tha Vokshi. Nga ana tjetër, ministrja Koçiu tha se për aktin e mjekëve do ketë ndëshkim ligjor dhe moral dhe se me amendimin i ligjit për urdhrin e mjekut e farmacistit në të tilla shkelje do t'u hiqet përjetësisht licenca. "Kam detyrën morale për të cekur sërish çështjen tonë të

famshme të Onkologjikut. Padyshim që abuzimi i rëndë që ata kanë luajtur me jetën e të sëmurëve duke kaluar çdo lloj norme, ka vetëm një përgjigje: ndëshkimin ligjor, administrativ e moral. Do mbajnë mbi shpinë jo vetëm peshën e ligjit, por edhe moralin e turpit. Për të sanksionuar me ligj të gjithë ata mjekë, ata që nuk mund t'i quaj më as profesionistë, që e trajtojnë jetën njerëzore si mall në

tregun e shumicës do kërkojmë ndryshime në aligj, do u hiqet e drejta e ushtrimit të detyrë në rast se bëjnë sjellje amorale. Kam lexuar qëndrime nga ato kritiket... Kam lexuar e dëgjuar çdo qëndrim, çdo zë. Nuk mund të përballet çdokush që e vazhdon punën me vendosmëri e profesionalizëm të lartë, që janë shembuj të ekipeve mjekësore. Shumëkush nga ne ka një eksperiencë të mirëfilltë

sa i përket kujdesit shëndetësor në shëndetin publik. Ne vlerësojmë ndershmërinë, abuzuesit do marrin në çdo kohë ndëshkimin e merituar. Do i listojmë në Kuvend ndryshimet në ligjin për Urdhrin e Mjekut", u shpreh ministrja. Por zotimi i ministres nuk i bindi deputetë e pozitës të cilët duke i rënë tavolinave me duar, këmbëngulën për largimin e ministres. "Jep dorëheqjen!", tha Bardhi.

### Zbardhen debatet e forta në Kuvend

## Belinda Balluku përfaqëson krimin e organizuar në qeveri, çon paratë e shtetit tek kompanitë e kriminelëve dhe gjezdis botën me lekët e shqiptarëve, opozita i plas skandalet zv/kryeministres

Elmas BOGDANI

Skandali në spitalin "Onkologjik" ndezi debate të forta dje në Parlament. Kryetari i Grupit të PD-së, Gazment Bardhi replikoi dje ashpër me zv/kryeministren Belinda Balluku, të cilën e ka quajtur si përfaqësuesen e krimit të organizuar në qeveri. Shkak për sherrit janë bërë deklaratat e Ballukut se falë PS u realizua reforma në drejtësi dhe ndaj po vepron ndaj të korrumpuarve. "Reforma në Drejtësi është bërë nga PS, keni qenë aty dhe se bëtë kurrë dhe nëse sot drejtësia është duke vënë në vend të drejtën e qytetarëve është duke u bërë për shkak të asaj reforme dhe transparencës që ka krijuar PS dhe qeveria. Këto historitë me ministrat që duhet të largohen, ju mund ta kërkon por ministri do vazhdojë se po e bën punën mirë", tha Balluku. Por gjatë debatit, Bardhi ka thënë se Balluku ka çuar paratë e shtetit tek kompanitë e krimit të organizuar, ndërkohë që e ka quajtur zv/kryeministren si të përfshirë në korrupsion. "Ajo gjezdis botën me lekët e shqiptarëve, na tregon ajo drejtësinë neve. Një përfaqësuese e krimit të organizuar, na flet për drejtësinë. Ke ti ftyrë të përmendësh drejtësinë?! Ti (Belinda Ballukut) je përfaqësuese e krimit të organizuar në qeveri", tha Bardhi.

### Opozita sulmon mazhorancën

Jo vetëm Bardhi, por edhe deputeti i PD-së, Dashnor Sula tha në Kuvend se në burg janë njerëz të mazhorancës dhe jo të opozitës. "Na ndërprisni rrogën, mandatin, por jo të na prisni fjalën. E ke bërë modë kryetare. Po të jetë fjala për procedurë, duhet të respektohet. Po institucionet e tjera të Shqipërisë, qeverisë, a kanë një procedurë? Kush është procedura? Është parandalimi, i abuzimit, i vjedhjes, i korrupsionit. Më gjeni një rast kur është bërë një parandalim. Ma gjeni një rast të vetëm?! Sa për drejtësinë që flitet këtu, kush i ka në burg njerëzit, kunetërisht, baxhanakët, apo të afërmit, juve apo ne?", tha ai.

### Zhupa dhe Mziu denoncojnë abuzimet me kompanitë telefonike

Nga ana tjetër deputetja e PD Ina Zhupa, nga foltorja e Kuvendit denoncoi abuzimet me kompanitë telefonike. Ajo u shpreh se dy kompanitë bien në dakordësi me njëra-tjetrën për ti vendosur njësoj çmimet. "Një temë sensitive për qytetarët duke qenë se kemi këtu drejtuesin e AKEP, lidhet me tarifat e kompanive celulare. E para ka të bëjë me hakërimin që i ndodhi "ONE", të dhënat që u zhdukën dhe u vunë në përdorim të të tretëve nga ky përdorim, mungesa e shërbimit



tek përdoruesit nuk mori përgjigje nga AKEP. Në përgjigje ju i thoshit klientëve që ju si përdorues mund ti drejtoheni gjykatës ose na sillni ankesa neve. Nuk ka nevojë t'ju sjellin ankesa sepse afera është e madhe, gjendja dihet nga të gjithë, kur ndërprerja e sinjalit ishte bërë e vazhdueshme. Dhe ju duhet të kishim marrë masat e nevojshme për të vënë gjoba, për të monitoruar. Dy kompanitë organizohen me njëra tjetrën dhe i kanë çmimet njësoj, i rrisnin çmimet në mënyrë të koordinuar, i kanë paketat njëloj", tha ajo. Po ashtu, deputeti demokrat, Xhelal Mziu ngriti si shqetësimin dyfishimin e çmimit nga kompanitë telefonike. "Ky fenomen nuk ishte pak vite më parë sepse kishim 4 kompani konkurruese,

kishim edhe telefoninë fikse. Ajo se çfarë ka ndodhur vitet e fundit është për shkak të duopolit midis këtyre dy kompanive. Kujtoj që par disa viteve të lusnin për të shkuar tek një kompani celulare, të oferonin tarifa konkurruese. Sot është e kundërta. Në dallim nga vendet e tjera të BE dhe rajonit ku ulja e tarifave është në mënyrë permanente. Mjafton të shkosh në çdo lagje të kryeqytetit dhe në qytete të tjera ka pafund raste të ankimit sepse nuk respektojnë kontratat. Kemi dyfishim të çmimit dhe përgjysmim të shërbimit ndaj qytetarëve", tha ai.

### Alarmi i Luan Baçit

Gjithashtu, ndërprerja e energjisë më 22 qershor është ngritur si shqetësim në Kuvend nga deputeti i PD Luan Baçi, i cili u shpreh se

shkëputja e energjisë po ndodh në mënyrë të vazhduar dhe nuk mbahet asnjë përgjegjësi. Sipas tij, ministrja e Energjitikës është duke u marr me plane të tjera. "Shkëputjet e energjisë elektrike po kthen në një problem në vend. Në bregdet kishte shkëputje të gjata të energjisë dhe të shkëputjes me ujë para disa ditësh. E ndërprisni energjinë sa herë të doni dhe pa paralajmëruar. Jemi në fillim të sezonit veror dhe ende nuk kemi dëgjuar një plan nga zonja ministre për përballimin e konsumit të energjisë të energjisë për shkak të rritjes së konsumit edhe nga pushuesit. Sigurisht që zonja ministre me shefin e madh po bëjnë të tjera plane atë të blerjes së energjisë me çmime tepër të larta për të justifikuar pse jo edhe pagesat që kryhen në këtë situata emergjente", tha ai. Për deputetin, abuzimet me tenderat në sektorin e energjitikës kanë arritur nivelet më të larta. "Të dhënat nga thesari i shtetit dëshmojnë se në këtë sektor abuzimet me tenderat ka arritur në nivele alarmante. Të gjitha tenderat e OSHE ne sektorin e it nga viti 2018 deri më sot fitohen nga 3 kompani në intervale që luhaten nga 97 deri në 99 për qind të fondit limit që kap shumën e 16 mln euro. Energjitika është një nga sektorët me gropën e zezë të korrupsionit të qeverisjes", tha ai.

### Gogu tallet me Nokën: Muli si çoban me ujkun në zemër që ankohet pse i zvogëlohet tufa në vathë

Nënkryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Toni Gogu, replikoi dje në Kuvend me deputetin e PD, Flamur Noka teksa ky i fundit më herët lëshoi akuza nga foltorja. Duke iu referuar Sali Berishës, Gogu ironizoi Flamur Nokën se s'mund të ligjërojë ai për korrupsionin teksa është bërë mburojë e ish-kryeministrit me

masë "arrest shtëpie" nga GJKKO. "Ti harron që ngjason me ata çobejtë që në krye të qoshes kanë vënë ujkun dhe ankohen pse iu zvogëlohet tufa në vathë. Mos fol për korrupsionin, por eja te komisioni i posaçëm dhe t'u japim shqiptarëve atë që presin, luftë ndaj korrupsionit kudo shfaqet. Por Muli me ujkun në zemër

dhe vathën bosh mos vazhdo të flasësh. Eja të bëjmë luftën ndaj korrupsionit në çdo qelizë. Leri llafet dhe eja t'i futemi punës", tha Gogu, duke përsëritur ftesën ndaj opozitës, e cila ka zgjedhur të bojkotojë pjesëmarrjen në Komisionin e Posaçëm Parlamentar për Mirëqeverisjen- Sundimin e Ligjit dhe Antikorrupsionin.

### Zyrtarizohet largimi i Alibeajt nga grupi i PD, Nikolla lexon shkresën në Kuvend

Është zyrtarizuar largimi i Enkelejd Alibeajt nga grupi parlamentar i Partisë Demokratike. Kryetarja e Kuvendit, Lindita Nikolla lexoi dje në seancën plenare shkresën e dërguar nga Alibeaj, i cili njofton se nuk është më pjesë e grupit të PD.

Ky vendim i Alibeajt erdhi pasi vula e Partisë Demokratike me vendim të Gjykatës së Apelit i kaloi Sali Berishës. Vetë Alibeaj kishte njoftuar në një postim në rrjetet sociale se s'mund të jetë pjesë e atij grupi që drejtohet nga Berisha.

Abuzimet galopante te Onkologjiku, ja si e zbuloi KLSH

# Skandalin tek Onkologjiku duhet ta hetojë SPAK, të përfshirë ministra, kreu i KLSH zbulon se ka problematika më të mëdha edhe në spitale të tjera, ja abuzimet galopante të mjekëve me ilaçet, pacientëve të tjerë nuk u jepnin recetat për rimbursim, zbardhet raporti alarmant

Xhoana VRANIÇI

**K**reu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Arben Shehu tha dje se skandali tek spitali Onkologjik në QSUNT është edhe më i rëndë se ajo që ka zbuluar Prokuroria e Tiranës. Ai tregon se kishte bërë një audit në 2022 rreth situatës në këtë spital, ku zbuloi një numër të madh shkëlqesh dhe kryesisht edhe për rastin e aparatit të kobalit që ishte kallëzuar në prokurori sipas ligjit, e cila u la nga viti 2021 jashtë çdo standardi në ambiente të papërshtatshme pavarësisht rrezikut real të jetës së shumë njerëzve. Por pavarësisht raportit të KLSH-së, nuk pati asnjë reagim nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë apo institucioneve të tjera.

## KLSH thirrje të ndërhyjë SPAK

Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Arben Shehu tregoi se nga auditimet që po mbyllën në sistemin shëndetësor publik, situata është aspak e mirë jo vetëm tek Onkologjiku gjë që nënkupton se problemi është më i thellë dhe përfshin sistemin dhe jo vetëm disa mjekë, siç po përpiqet Rilindja ta cilësojë. Kërkesa e kreut të KLSH për ta hetuar SPAK, nënkupton gjithashtu se skandali përfshin zyrtarë institucionesh deri në rang ministrash, gjë që është kompetencë e SPAK-ut, dhe nuk është thjeshtë përgjegjësi mjekësh. “Jemi në kushtet kur ne kemi konstatuar një sërë problematikash gjatë auditimeve, sepse dua të theksoj këtu që janë kryer disa auditime dhe do të kryhen disa auditime, pjesë e të cilëve është edhe trajtimi te spitali Onkologjik. Dhe njëkohësisht dua t’iu them me përgjegjësi të plotë se jemi në një lloj trajtimi të thelluar qoftë në auditim për ato procese që janë të papërfunduara, njëkohësisht jemi në një trajtim të thelluar juridik për ato raste të cilat janë të përfunduara. Dua t’iu bëj me dije se trajtimi i problematikave në spitalin Onkologjik, pavarësisht rëndësisë që ka është vetëm një pjesë e segmentit të situatës reale”, tha kreu i KLSH-së. Por Arben Shehu thotë se kjo dosje me gjetje konkrete duhet hetuar nga SPAK dhe jo nga Prokuroria e Tiranës. “Problematika për fat të keq është më e madhe dhe ne kemi qenë të detyruar dhe jemi të detyruar që të ndërthurim përgjegjësitë jo vetëm të një institucioni, për të nxjerrë në pah një tablo të plotë të të gjithë situatës në këtë drejtim. Dua t’iu theksoj se është shumë e rëndësishme që pavarësisht vlerësimit për punën e bërë nga ana e Prokurorisë jemi të mendimit dhe kemi diskutuar në mënyrë të padiskutueshme se kjo është një kompetencë e Prokurorisë Speciale për shkak të përcaktimeve që ka në ligj dhe për shkak të rëndësisë që ka problematike që ne do ta bëjmë publike në vijim”, tha kreu i KLSH-së, Arben Shehu.



Çfarë zbuloi raporti i KLSH?

Raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit e ka zbuluar disa vite më parë atë që ndodhte në spitalin Onkologjik, por asnjë prej institucioneve nuk denjoi që ta merrte parasysh. Ky raport tregon se Ministria e Shëndetësisë ishte në dijeni për atë që ndodhte te Onkologjiku, por mbylli sytë dhe la mjekët të bënin pazar me jetët e pacientëve, duke u hequr ilaçet për t’i shitur te farmacitë private, që më pas të bënin pushime në Maldive e Tajlandë. Në këtë raport tregohen shkëlqesh mjekëve dhe drejtuesve të Spitalit Onkologjik, që nga mbushja e recetave për pacientë që kishin ndërruar jetë, deri te mosplotësimi i asnjë recete për pacientët e tjerë, të cilët i privonin nga ilaçet që i mbajnë në jetë. “Pavarësisht aksesit të kufizuar në informacion, nga grupi i auditimit janë detajuar procedura thelbësore shtesë auditimi bazuar në aksesin manual në sisteme dhe kryqëzimin e të dhënave. Konkretisht, për mjekë të caktuar të cilat kanë rezultuar në gjeneruesit më të lartë të rimbursimit sipas rajoneve përfaqësuese dhe kritereve të tjera të riskut nga ana jonë, kemi kryer shkarkimin manual të të gjithë pacientëve të këtyre mjekëve sistemit AHIS. Nga ana tjetër janë analizuar recetat e përmbledhura sipas çdo pacienti për të cilët këto mjekë i kanë lëshuar referuar sistemit të recetës elektronike e-Rx. Në vijim janë kryqëzuar të dhënat e pacientëve përfitues të rimbursimit me pacientët në përgjegjësi të mjekut sipas sistemit AHIS, nga ku ka rezultuar që një pjesë e pacientëve përfitues nuk janë pjesë e mjekut që ka gjeneruar recetën. Kjo mund të ekzistojë për arsye se pacientët e ndryshojnë mjekun të paktën një herë në vit sipas kërkesës së tyre kur kjo miratohet, si dhe ekziston risku që këta pacientë të jenë regjistruar vetëm për të përfituar rimbursimin dhe më pas nuk gjenden më në regjistrin e të siguruarve AHIS. Nga ana tjetër, për këto mjek janë krahasuar ID të përfituesve me ID të pacientëve që kanë ndërruar jetë sipas informacionit të përcjellë nga DPGJC nga ku kanë rezultuar 30 raste të cilat janë evidentuar gjenerimi dhe ekzekutimi i recetave për pacientë të

cilët kanë ndërruar jetë, gjë që na përcjell në konkluzionin e përfitimit të padrejtë të rimbursimit”, thuhet në auditin e KLSH-së.

## Skandali

KLSH tregon se si mjekët e Onkologjikut plotësuan në të paktën 30 raste receta me ilaçe të rimbursueshme për pacientë që kishin ndërruar jetë. “Nga auditimi konstatohet se për kategoritë me rimbursim të pjesshëm dhe kategorinë pensionistë, janë gjeneruar dhe ekzekutuar më shumë se tre barna për recetë, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në VKA nr. 34 datë 12.12.2019 “Për miratimin e rregullores nr.1 datë 12.12.2019 mbi procedurat e përshkrimit, gjenerimit, ekzekutimit, kontrollit dhe rimbursimit të recetës elektronike e-Rx” ku përcaktohet se “Pika II.9 “Në recetat me rimbursim të pjesshëm dhe ato të kategorisë “pensionist” do të lejohen deri në 3 barna për recetë”... Mbi gjenerimin e recetave për të njëjtin pacient nga më shumë se një mjek dhe/ose në DRF të ndryshme përgjatë periudhës objekt auditivi Nga auditimi janë konstatuar raste kur për të njëjtin pacient ekzistojnë receta nga më shumë se një mjek dhe qendër shëndetësore përkatëse, duke vendosur në dyshim procesin e rimbursimit të këtyre recetave dhe ekzistencën e pacientit referuar regjistrin elektronik të të siguruarve”. Por, përderisa mbushnin recetat e pacientëve të vdekur, të tjerët që luftonin për jetën me sëmundjen e rëndë lireshin në mëshirë të fatit, pasi Spitali Onkologjik nuk kishte një Sistem Regjistri Elektronik, çfarë do të thotë se nuk dihej numri i pacientëve me kancer, sa kohë

kishte që trajtoheshin apo si duhej të ndryshohej trajtimi i tyre me ilaçe.

## Rimbursimi

Gjithashtu, KLSH në auditin e bërë tregon mungesën e disa barnave të domosdoshme. Kjo mungesë sipas Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka ardhur për shkak të mungesës së evidentimit të daljeve nga recetat pa rimbursim, çfarë sjell mungesën e dijenisë mbi sasinë e barnave të mbetura në depo. “Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të raport kontrolleve të plota me inventarizim për vitet 2021 dhe 2022, në subjektet “Medigreen”, “Bio Plus”, “Geni Lori”, “Gega”, “Joger”, “Juli’s”, “Nacional”, “Kamel Farma”, “Fatjona”, “Boçi”, “Amelia”, “Mirçe”, “Toni”, “Well Pharma”, “Gledis” dhe “Eva Farma”, nga SKF dhe DRF Tiranë, kanë rezultuar se nuk është bërë tërheqja e recetave pa rimbursim për barnat e rimbursueshme në kundërshtim me pikën 12, Kapitulli 1, të Rregullores nr. 3, datë 22.10.2014. Konkretisht, nga grupet e kontrollit nuk është plotësuar pika 18 e DU4 dhe DU6, duke mos reflektuar sasinë e barnave nga recetat pa rimbursim. Mungesa e evidentimit të daljeve nga recetat pa rimbursim, nuk reflekton saktë gjendjen e mbartur të barnave të përzgjedhura për inventarizim dhe rrjedhimisht krahasimin e tyre me gjendjen fizike të konstatuar nga ana e grupit të inspektimit. Mos marrja në konsideratë e efektit të këtyre daljeve, sjell pasojat në mungesën e evidentimit të diferencave në plus në inventarizim, të cilat janë objekt penaliteti deri në zgjidhjen e kontratës, referuar parashikimeve të kontratës F2020 dhe F2021”, raporton KLSH.

## Shqipëria fiton arbitrazhin 236 milionë euro me Bankers Petroleum

Bankers Petroleum do të duhet të derdhë minimalisht 100 milionë dollarë në arkën e shtetit shqiptar për shkak se ka nuk ka llogaritur siç duhet kostot e prodhimit. Qeveria shqiptare ka fituar gjyqin e arbitrazhit kundër kompanisë kineze në lidhje me mosmarrëveshjet që ishin ngritur mes saj dhe shtetit shqiptar për llogaritjen e kostove të prodhimit. “Mosmarrëveshja, e sjellë në arbitrazh nga Bankers, lidhej me procedurën e rikuperimit të kostove sipas Licencë Marrëveshjes dhe Marrëveshjes Hidrokarbure të lidhura me Bankers të vitit 2004, në lidhje me operacionet në fushën naftëmbajtëse të Patos Marinzës. Në përfundim të gjykimit, dhe pse Bankers kërkoi me anë të arbitrazhit të mbajë të gjitha shumat e gjeneruara nga prodhimi i fushës së Patos Marinzës me anë të procedurës së rikuperimit të kostove, Shqipëria ja doli të ketë epërsi mbi shumë nga çështjet e interpretimit të Marrëveshjeve përpara Tribunalit,” deklaroi përmes një njoftimi

zyrtar ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Sipas vendimit, gjykata ka gjetur të drejtë interpretimin e shtetit shqiptar për aspekte të rëndësishme të marrëveshjeve, në veçanti që kategoritë e kostove të rikuperueshme janë të listuara në mënyrë specifike në marrëveshje, kështu që kostot e tjera si pagesat e bëra për operacionet kandidate të Bankers ose pagesat për zgjidhjet e mosmarrëveshjeve me mirëkuptim me kompani të tjera për furnizimin me naftë nuk mund të rikuperohen, ndryshe nga sa pretendonte Bankers. Gjykata konkludoi gjithashtu se nuk mund të pretendoheshin as kostot e kundërshtuara që ishin bërë, të tilla si investimet në marrëdhëniet me komunitetin që kane qenë të ekzagjeruara ose pagesat për qiratë e tokës. Tribunali dakord me Shqipërinë se kontratat e rëndësishme nënkontraktore duhej të jepeshin nëpërmjet proceseve rigoroze të tenderimit, duke rritur transparencën dhe efikasitetin e projektit.

“Mendo për pensionin privat sa nuk je vonë”, ish-ministri paralajmëron qytetarët

# Arben Malaj: Ja informacionet që duhet të dini për rritjen e pagave më 1 korrik dhe kapacitetet ekonomike që ka sot Shqipëria për të bërë ndryshime të mëdha për të ardhurat e pensionistëve

Xhoana VRANIÇI

**I**sh-ministri i Financave, Arben Malaj ka komentuar situatën ekonomike dhe sociale në vend gjatë një interviste për televizion “A2 CNN”. Duke folur për rritjen e pagës mesatare që pritet të shkojë 9000 euro nga 1 korriku, zoti Malaj theksoi se ky është një premtim duhet të jetë pjesë e politikave stimuluuese. Për ish-ministrin e Financave vetëm me një skemë mbrojtjeje sociale për klasat e mesme dhe shtresat në nevojë mund të ketë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social e politik. Nga ana tjetër, ish-ministri Arben Malaj, kur u pyet nëse kjo skemë aktuale garanton pensionin për të gjithë të punësuarit e sotëm, theksoi se: “Do ta rekomandoja të mendoje dhe skemën e pensionit privat sa nuk je vonë. Skema publike nuk do të ketë mundësi edhe për shkak të 100 faktorëve”.

**-Zoti Malaj, diskutohet e diskutohet për rritje të pagës kur jemi vetëm pak ditë nga mbyllja e muajit dhe pyetja është se a rrezikohet që ky premtim të mos mbahet?**

E para, premtimi është detyrim sepse ne dimë që pagat reale nuk janë rritur dhe pse kemi rritje të pagave minimale, sërish inflacioni ka qenë i lartë. Nuk themi për inflacion mesatar që kalkulohet nga INSTAT dhe miratohet nga Banka e Shqipërisë. Flasin për dy lloje inflacionesh që godasin shtresat më kritike në nevojë në vend, është për pensionistët që kalkulohet nga INSTAT, gjithashtu është dhe inflacioni ushqimor nga INSTAT. Shqipëria ka nevojë të forcojë mbështetjen sociale sepse sipas UNICEF thuhet se niveli i varfërisë në Shqipëri është shumë i lart, një në dy fëmijë vuan nga varfëria ushqimore. Një rritje page pa u rritur produktiviteti mund të na çojë sërish në spirancën paga dhe inflacion. Në vend janë disa ministri të cilat mbështetën apo disa grupe profesionale, siç janë mjekët, mësuesit, forcat e rendit. Nuk është se është një rritje për të kompensuar rënien e të ardhurave nga paga, nga pensionet, nga mbrojtja sociale. Duke patur parasysh krizën në rritje që kemi në sektorin e shëndetësisë dhe të arsimit dhe domosdoshmërinë për të mbështetur më mirë forcat e policisë sepse rendi publik është prioritet për një zhvillim të qëndrueshëm. Kjo gjë duhet të jetë pjesë e politikave stimuluuese, ky premtim që është bërë.



**-A mundet rritja e pagave të ndal këtë hemorragji që grupmosha të ndryshme që të mos largohen nga vendi?**

Jo, sepse rritja e pagave do të ketë një kufi. Problemi ndër vite i të rinjve ka qenë mënyra si të bëjnë karrierë, frika nga paqëndrueshmëria në administratë, nga rotacionet politike, kultura jo e duhur e komunikimit midis shkallëve të ndryshme të qeverisjes si drejtor, nën drejtor, përgjegjës sektori etj, dhe nuk është vetëm problem financiar. Për nivelin që jemi tani, efekti financiar është i domosdoshëm por është jo i mjaftueshëm. Ndjaj në këtë aspekt është e nevojshme të shikohet një kuadër më i gjerë, jo thjesht si një instrument, rritja e pagave por duke ndërhyrë edhe elementet e tjerë të cilat plotësohen.

**-Duke kujtuar dhe reformën për rritjen e pagës minimale, edhe vitin e shkuar shtyhej ndryshe nga ca premtonte ish-ministrja Ibrahimaj, u premtua në prill dhe më pas u arrit në qershor. Këto vonesa i shihni si të vështira nga ana procedurale, një neglizhencë e institucioneve?**

Jo, unë besoj se janë përlogaritje kritike pasi qeveritë shqiptare sepse i kërkohet në mënyrë të përsëritur dhe i bëj thirrje qeverisë që të bëjë kujdes me borxhin publik. Pra nëse do rritet paga, me çfarë do ta kompensosh. Por nëse të ardhurat në buxhet vijnë nga rritja e inflacionit, ato nuk janë të ardhura që duhet mbajtur për të rritur investimet apo për të mbyllur pikat e dobëta të buxhetit por duhet të përfshihen në një skemë besimi.

**-Të dhënat e INSTAT tregojnë se veçse anemike, rritja e pagës mesatare po shoqërohet dhe nga një thellim i hendekut mes privatit dhe shtetit. Sa e vështirë është që edhe privati ta ndjek këtë rritje të pagave që ka vënë qeveria, deri në 900 euro?**

E para, në qoftë se privati do ta rrisë, ai do shkojë në rritje inflacioni automatikisht se ai nuk ul fitimet

e tija por konkurrenca nuk është aq e plotë sa duhet, funksionimi i tregut të lirë ka pengesat dhe deformimet e tija, kështu që keni parasysh që p.sh; tani në Vlorë dhe në zonat bregdetare thuhet se është rritur çmimi i ushqimit por edhe i fjetjes me rreth 20%. Të gjitha këto janë për shkak të pagave që janë rritur, presionit që erdhi nga pagat. Ndërsa përfshirja në administratë publike me një bonus më të mirë me shërbime dhe një promovim më të mirë, duhet të ketë parasysh edhe cilësinë e përzgjedhjes.

**-Hendeqe janë rritur dhe mesasaj që të punësuarit marrin në profesione të ndryshme. Sipas INSTAT punonjësit e bankave dhe të kompanive të sigurimit patën pagën mesatare më të lartë në harkun e muajve, janar-mars me gati 134 mijë lekë. Si mund të sheshohen këto hendeqe?**

Nuk sheshohen dhe do të gënjënim po të thonim se sektor të ndryshëm kanë shkallë fitimi të ndryshme. Po të shikoni raportet përfundimtare të ndryshme të bankave, kanë fitime të konsiderueshme në momentin kur ato japin sa më shumë kredi. Por patjetër, se një që punon në IT apo sektor të veçantë, patjetër që ka një pagë shumë më të madhe se një tjetër që bën një punë modeste.

**-Me gjithë zgjedhërimin e pagës mesatare që shpresojmë të shkojë 900 euro, Shqipëria vijon të mbetet e fundit, pas Kosovës edhe në rajon. Bosje Hercegovina është vendi me pagën mesatare më të lartë me 893 euro, Mali i Zi me 885 euro dhe Serbia me 880 euro, si duhet t'i lexojmë këto shifra, megjithëse synohet të shkojë 900 euro.**

Nëse do të shkojë në 900, do t'i tejkalojë këto por shqetësimi i madh se ky tejkallim ka një bazë reale të qëndrueshme që të jetë real. Disa vite të fundit edhe biznesi vetë, edhe fasonët vetë që janë më pagat më të ulta, ishin dakord që të bënin, pranonin të bënin një rritje graduale pasi e shihnin konkurrencën. Ajo

që kërkohet nga qeveria është që qeveria të komunikonte në moment kur do të fus një politikë të re pagash sepse ato do të bënin buxhetet e tyre dhe çmimet e reja për klientët e tyre. Politikat e pagave duhet të harmonizohen, nuk është e domosdoshme që atë çfarë bën qeveria ta bëjë edhe biznesi privat, por të harmonizohen me njëri-tjetrin.

**-Që kjo rritje page në këtë vlerë që flitet çfarë do të kishit bërë ndryshe për të ulur rritjen e inflacionit?**

Duhet të theksojmë se duhet të bëhet ndryshe dhe duhet bërë pjesë e politikës nga të gjitha forcat politike dhe të rotacionit të tyre, është që nuk mund të ketë një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social, politik, të një vendi Nëqoftëse nuk ka një skemë të mirë të mbrojtjes sociale për shtresën e mesme dhe asaj në nevojë. Ndjaj duhet një rishpërndarje më e mirë e parave nga të ardhurat shtesë nga inflacioni.

**-A ka kapacitet ekonomik sot Shqipëria për të rritur pensionet dhe me këtë skemë pensionesh që ka aktualisht?**

Skema ka një sërë problematikash, është deficitare te ne dhe te vendet më të zhvilluara në botë. Shqetësimi jonë si ekonomist është që deficit është shumë i madh. Deficiti i skemës shoqërore dhe shëndetësore, ishte sa 70% të investimeve të brendshme të Shqipërisë dhe ishte 1.58 herë sesa investimet e huaja. Paratë që hedhim këtu, na reduktojnë burimet edhe për politikat sociale dhe për prioritetet e zhvillimit të qëndrueshëm që duhet të jetë me ritme më të larta dhe duhet të jetë i drejtë pasi sot bota ka vënë theksin te kohezioni social.

**-Në këto kushte ekonomike që është Shqipëria, pensionistët mund të presin një ditë rritje reale të pensionit?**

Unë besoj se ka premisa pozitive se po rriten pagat në raport me atë që prodhon ekonomia që të ketë një mbështetje më të mirë. A do jetë e plotë, nuk e them dot pasi Banka Botërore tani po bën një studim tjetër për skemën e pensioneve në Shqipëri. Skema e parë synoi rritjen e moshës së pensionit por synoi dhe rritjen e viteve të punës. Që nga viti 2015 ka rezultuar se kërkesa për sa më shumë vite pune në kushte kur dhe arshivat janë të tmerrshme dhe problematike për t'i gjetur vitet e punës, rriti numrin e pensionistëve me pension të pjesshëm. Kjo pastaj i bëri më të varfër ato në pritshmëritë e tyre.

**-Kjo skemë e re që po shikohet dhe nga Banka Botërore, ka kohë do që të implementohet në Shqipëri?**

Në momentin që qeveria do bie dakord, disa element të skemës mund të jap efekte direkte, sic janë vitet e punës dhe jetëgjatësia. Sa i përket pensioneve suplementare, ne nuk kemi patur kulturë që ta sigurojmë vetë vetveten. Ne nuk kemi patur para, ku merrje paratë e i fusje për vitet e pensioneve, të merrje paratë e dua dhe t'i investojë në vend tjetër.

**-Është një skemë që çdo pensionist është i garantuar që të marr pensionin e tij dhe ne nesër të marrim pensionin tonë?**

Do të rekomandoja që të merrnit dhe skemën e pensionit privat sa nuk je vonë. Skema publike nuk do të ketë mundësi edhe për shkak të 100 faktorëve.

**-Ju thonë se skema e pensionit nesër mund të mos jetë efikase dhe shikoni pensionin privat por a e quani këtë një lloj suksesi?**

Pensionin privat shikohet si element suplementar por skema publike do të funksionojë pasi e garanton shteti. Është një menaxhim i kujdesshëm.

## Rindërtoi 23 banesa në Lezhë, Rama i jep Medaljen e Argjendit për Vlerësim Profesional, Halil Kastratit

■ Kryeministri Edi Rama i dorëzoi dje Medaljen e Argjendit për Vlerësim Profesional, Halil Kastratit, shqiptarit nga Kosova i cili kontribuoi në rindërtimin e 23 banesave të dëmtuara nga tërmeti në Lezhë. Kryeministri vlerësoi kontributin e tij të posaçëm në këtë proces. “Faleminderit! Nderim për Halil Kastratin, me mirënjohje për kontributin e tij të posaçëm në ndërtimin e 23 banesave për familjet e prekura nga tërmeti në qytetin e Lezhës”, u shpreh Kryeministri, ndërsa i dorëzoi Medaljen e Argjendit për Vlerësim Profesional. Halil Kastrati, kryetari i shoqatës shqiptare “Jetimët e Ballkanit” ka financuar projektin e ndërtimit të 23 banesave në bashkinë Lezhë. Ky nuk është kontributi i parë në ndihmë të personave në nevojë, pasi më herët me financimin e tij ka përfunduar ndërtimi i 35 shtëpive në Kukës, Krumë dhe Tropojë.



■ GJK shfuqizon tatimin 15 % për profesionet e lira, Qëndresa Qytetare: Doli kundër gjobëvënies

# Gjykata Kushtetuese shfuqizon tatimin 15% për profesionet e lira, mbetet në fuqi 23% për ata me të ardhura mbi 14 mln lekë, zbardhen detaje nga vendimi

Rigels SELIMAN

**G**jkata Kushtetuese shfuqizoi dje tatimin 15 % për profesionet e lira. Sipas këtij vendimi, ata që kanë të ardhura deri në 14 milionë lekë nuk do paguajnë tatim. Ndërsa ata që marrin mbi 14 milionë lekë do të takohen 23%. Pas shqyrtimit gjyqësor gjykata me shumicë votash vendosi të shfuqizojë 2 pika: Neni 69, pika 1, shkronja "dh", fjalia e dytë dhe e tretë e ligjit nr. 29/2023 dhe neni 4 i VKM-së nr. 753/2023, si dy pika që cenonë lirinë e veprimtarisë ekonomike për shkak të mosrespektimit të parimit të sigurisë juridike.

## Vendimi

Në vendimin e lexuar nga vetë kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, Holta Zaçaj thuhet se ishte një masë joproporcionale dhe se këto kategori do duhet të takohen në 2029 si të gjithë bizneset e tjera të vogla. "Lidhur me themelin e pretendimeve të kërkuarve, Gjykata pa vënë në dyshim hapësirën e gjerë të vlerësimit të ligjvënësive dhe diskrecionin e tij në fushën fiskale, vlerësoi se neni 69, pika 1, shkronja "dh", fjalia e dytë dhe e tretë e ligjit nr. 29/2023 dhe neni 4 i VKM-së nr. 753/2023, cenonë lirinë e veprimtarisë ekonomike për shkak të mosrespektimit të parimit të



sigurisë juridike (në kuptim të pritshmërive të ligjshme dhe qartësisë së normës) dhe parimit të proporcionalitetit. Gjykata arriti në këtë përfundim duke mbajtur në konsideratë skemën tatimore dhe në veçanti faktin se detyrimi tatimor prej 15 % ndaj kësaj kategorie tatimpaguesish filloi të zbatohet menjëherë pa u lënë kohë të mjaftueshme atyre të përshtateshin me skemën e re tatimore. Sa me sipër, Gjykata mbajti në vëmendje se ndonëse ligji ka hyrë në datën 18 Maj 2023 dhe i shtrinte efektet e tij nga data 1 Janar 2024, lista analitike e shërbimeve hyri në fuqi në datën 23 Dhjetor 2023 sipas neni 4 të VKM-së nr. 753/2023 pra vetëm disa ditë para fillimit të efekteve të ligjit. Gjithashtu, Gjykata vlerësoi se norma e tatimit prej 15 % e parë së bashku me kohën e zbatimit të saj nuk e kalon

testin e proporcionalitetit, pasi nuk rezultoi të jetë masa më e përshtatshme, në kushtet kur ka masa të tjera alternative, të cilat vetë ligjvënësi i ka evidentuar të zbatohen për kategoritë e tjera të tatimpaguesve mbi të ardhurat. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, për arsyet e mësipërme, Gjykata vendosi me shumicë votash: Pranimin e pjesshëm të kërkesës dhe shfuqizimin e neni 69, pika, shkronja "dh", fjalia e dytë dhe e tretë e ligjit nr. 29/2023 dhe të neni 4 të VKM-së nr. 753/2023. Rrëzimin e kërtimeve për shfuqizimin e dispozitave të tjera të ligjit", thuhet në vendim. Ndërkohë vendimi përfundimtar do të shpallet i arsyetuar brenda afateve ligjore të parashikuara nga ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe nga Rregullorja

për procedurat gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese. Kujtojmë se janë rreth 29 mijë profesionistë të lirë që preken nga ky ligj. Kërkesa për të shfuqizuar tatimin u bë nga Partia Demokratike, ekspertët e licencuar, kontabilistët dhe avokatët, kërkesat e të cilëve u bashkuan në një të vetme.

## Reagon Qëndresa Qytetare

Ndërkohë Qëndresa Qytetare në një reagim mediatik theksoi dje se u votua kundër gjobëvënies, pasi me këtë taksë qindra sipërmarrje të lira do të kyçeshin dhe profesionistët do të ishin të ekspozuar përballë një tjetër vale eksodi. "Në vendimin e Gjykatës Kushtetuese argumentohet se nuk u respektua parimi i sigurisë juridike si dhe parimi i proporcionalitetit dhe se këto kategori do duhet të takohen në 2029 si

të gjithë bizneset e tjera të vogla. Që në fillimet e propozimeve të kësaj takse e ka cilësuar atë gjobëvënie, që do kishte pasoja fatale për profesionet e lira. Ky vendim nuk ishte rastësi pasi vjen një ditë pas protestës qytetare kundër Bandës Onkologjikut, teksa në 13 Qershor qytetarët u tubuan pikërisht përballë kësaj gjykate për të protestuar kundër taksës për profesionet e lira. Me këtë taksë qindra sipërmarrje të lira do të kyçeshin dhe profesionistët do të ishin të ekspozuar përballë një tjetër vale eksodi", thuhet në reagimin e saj. Sakaq Qëndresa Qytetare vlerëson se qeveria duhet të hartojë politika mbështetëse për profesionet e lira si një mekanizëm për nxitjen e sipërmarrjes dhe kthimin e Shqipërisë në një oaz të profesioneve të lira.

## Gjykata Kushtetuese rrëzoi taksimin e profesioneve të lira, Tabaku: Betejë e fituar për ne dhe qytetarët

■ Deputetja e Partisë Demokratike, Jorida Tabaku ka deklaruar se vendimi i Gjykatës Kushtetuese që rrëzoi tatimin 15% për profesionet e lira është një fitore për qytetarët. Në një deklaratë për mediat nga Kuvendi, Tabaku u shpreh se nuk kishte bazë ligjore për të tatuar atë kategori punonjësish. "Pas paraqitjes së argumenteve dhe fakteve ne fituam sot një betejë për të gjithë këto profesione të lira. Në fituam një betejë sepse GJK sot doli me vendim që tatimi mbi profesionet e lira është antikushtetues, që i diskriminonte profesionet e lira. Për këtë arsye nuk ka asnjë bazë ligjore që ky tatim të trajtohet ndryshe nga profesionet e lira. Kjo është një betejë e fituar e grupit parlamentar të PD, e profesionistëve të lirë, por më tepër është një betejë e fituar për qytetarët shqiptarë, për shtresën e mesme, për ata që punojnë me mundim dhe në mënyrë të padrejtë ishin duke u taksuar më shumë se çdo biznes tjetër", tha Tabaku. Ajo falënderoi të gjithë ata që besuan tek grupi parlamentar ri PD, teksa e konsideroi si një fillim të mirë për të pasur besim te institucionet. "Unë e konsideroj këtë një fillim të mirë dhe për të treguar se sot duhet të kemi besim tek institucionet, tek politika si mjet ndryshimi, por duhet të kemi edhe të ajo rrugë që kemi nisur që besoj është rruga e drejtë", nënvizoi Tabaku.

## Ndryshimet në ligjin për Shërbimin Veterinar, ministrja Denaj: Përmirësim i cilësisë dhe sigurisë së produkteve mjekësore veterinarë

■ Miratohen ndryshimet në ligjin për Shërbimin Veterinar. Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj u shpreh dje se, ndryshimet e rëndësishme në ligjin për Shërbimin Veterinar që synojnë përmirësimin e cilësisë dhe sigurisë së produkteve mjekësore veterinarë, rritjen e përgjegjësisë dhe efikasitetit të autoriteteve veterinarë dhe harmonizimin me standardet e BE-së, tashmë janë miratuar në Qeveri. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural përmes këtij ligji ndërmerr një hap të madh drejt modernizimit të shërbimeve veterinarë dhe përafrimit me standardet e BE-së, nënvizoi Denaj. Ministrja theksoi se, mbështetja dhe miratimi i këtyre ndryshimeve tregon përkushtimin e qeverisë për përmirësimin e shëndetit të kafshëve dhe sigurinë ushqimore në Shqipëri. Denaj u shpreh se, ky ligj sjell përmirësimin e cilësisë dhe sigurisë së produkteve mjekësore veterinarë, rritje të përgjegjësisë dhe efikasitetit të autoriteteve veterinarë në Shqipëri si dhe harmonizim me standardet ndërkombëtare dhe ato të BE-së.

## Vreshtari dhe ullishtari prej më shumë se 25 vitesh, kantina në Hajmel zgjerohet në agroturizëm

■ Në Hajmel, të Shkodrës Zef Pashuku ka ngritur Kantinën Zadrime, ku prej më shumë se 25 vitesh merret me vreshtari dhe ullishtari, duke investuar në zhvillimin e kultivarëve autoktonë. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj ndau dje në rrjete sociale shembullin e këtij agroturizmi, teksa vuri në dukje se, vitet e fundit, kjo kantina ka zgjeruar aktivitetin edhe me një restorant. Kantina pikë agroturistike pret turistë vendas dhe të huaj që kanë mundësinë të shijojnë produkte cilësore të verës dhe rakisë, shoqëruar me shijen e ushqimeve tradicionale shqiptare. Denaj tha se, gjithashtu, në Kantinën Zadrime po përgatitet një ekspozitë produktesh lokale, ku vetë kantina dhe fermerët e zonës do të ekspozojnë produktet e tyre 'Made in Albania'.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË



MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE  
DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

## NJOFTIM

### PËR FILLIMIN E PROCESIT TË QIRADHËNIES

Në zbatim të Vendimit Nr. 373, datë 20.6.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës TIP për dhënie me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit", i ndryshuar, kreu IV "Procedurat që ndiqen për dhënie me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit", pika 4.1, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural njofton fillimin e procesit për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për pasuritë me Nr. 810; Nr. 811/1; Nr. 811/2; Nr. 811/20; Nr. 811/21; Nr. 814; Nr. 816/1; Nr. 816/2; Nr. 816/3; Nr. 818; Nr. 821; Nr. 822; Nr. 823; Nr. 826/1; Nr. 826/2; Nr. 827; Nr. 829/1; Nr. 829/2; Nr. 829/3; Nr. 830 dhe Nr. 834/1; Zona Kadastrale Nr. 2570, me vendndodhje në fshatin Malinat, Njësia Administrative Velabisht, Bashkia Berat, qarku Berat".

# politikë

## Vangjush Dako kërkoj gjykim të shkurtuar, GJKKO vendos më 8 korrik nëse do ta pranojë ose jo

Gjykata e Posaçme do të shprehet në seancën e 8 korrikut, nëse do pranojë apo jo kërkesat për gjykim të shkurtuar të bëra nga ish kryebashkiaku i Durrësit Vangjush Dako, Fiqiri Farruku dhe Adrian Bulku. Gjyqtarja Elsa Ulliri rrëzoi kërkesën e disa prej te akuzuarve të tjerë për shpalljen e moskompetencën lëndore dhe për dërgimin e çështjes për gjykim në Gjykatën e Durrësit. Një kërkesë të tillë e bënë Fatmir Ejupi, Ferzilet Hajdëri, Adnand Toçila, Diana

Dedja, Bashkim Salillari dhe Hanza Reka. Pas rrëzimit të kësaj kërkesë këta të pandehur dhe avokatet e tyre kërkuar gjykim të zakonshëm dhe ndarjen e çështjes nga Vangjush Dako. Ndërkohë, prokurori Sotir Kllapi kërkoj rrëzimin e kërkesës. Avokatët vijuan me kërkesat e tjerat paraprake, ku u kërkuar dhe mos pranimit si provë e një akt ekspertimi të bërë së fundmi nga prokuroria e posaçme, përmes një eksperti për shëtitoren. Sipas avokateve, eksperti nuk ka licensë për

të kryer këtë lloj ekspertimi. Në këto kushte, gjyqtarja Ulliri u tërhoq për tu shprehur në seancën e radhës, në lidhje me kërkesat për gjykim të shkurtuar dhe për ndarjen e çështjes. Pas përfundimit të seancës, Vangjush Dako u shpreh se ka kërkuar gjykim të shkurtuar pasi nuk ka prova të reja dhe mund të zgjidhet çështja në këtë fazë. Ish kryebashkiaku i Durrësit Vangjush Dako akuzohet se ka kryer veprën penale "shpërdorim detyre", në dy raste. Njëri rast, ka të

bëjë me ndërtimin e një pallati në Durrës 11 vite më parë, i cili u shemb nga tërmeti në nëntor të vitit 2019 dhe rasti tjetër ka të bëjë me një tender për ndërtimin e një shëtitoreje në vitet 2014-2015, që i ka shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm prej 18 milionë lekë. Dako u arrestua në muajin qershor të vitit 2023 me urdhër të Prokurorisë së Posaçme dhe u la i lirë në shkurt të këtij viti, pasi SPAK nuk arriti të përfundojë hetimet e caktuara nga gjykata brenda afateve.

### Ja terrori i SPAK në qeverinë "Rama"

## Artur Meçollari: SPAK do na tregojë të vërtetën për lajthitjet Edi Ramës, nga urdhrat që i dha Engjëll Agaçit dhe Gardës për të mos i dorëzuar dokumentet agjentëve të BKH, te sulmet ndaj prokurorëve për sekuestrimin e Bazës Detare të Limionit dhe notat e fundit pozitive ndaj drejtësisë së re

Elmas BOGDANI

Ish-Zëvendës Komandanti i Forcave Detare të Shqipërisë, Artur Meçollari ka bërë një "skaner" të qëndrimeve të kryeministrit Edi Rama ndaj Prokurorisë së Posaçme. Sipas reagimit të Meçollari, Edi Rama ka bërë deklaratatë të papritura ndaj SPAK. Ai përmend urdhrat që i dha disa kohë më parë vartësve të vet për të bllokuar agjentët e BKH të sekuestrojnë dokumentet nëpër zyrat shtetërore, si edhe sulmet e Ramës ndaj SPAK për sekuestrimin e Bazës Detare të Limionit. "Lajthitjet kryeministore si një testi për SPAK-un? KM Rama është shprehur disa herë lidhur me punën e SPAK. Ai kohë më parë është shprehur se "nuk jemi republikë e prokurorëve". Kjo deklaratë u bë mbas këqyrjeve të vazhdueshme nga SPAK të sekretarive të disa ministrive, por që nuk u lejua nga Garda e Republikës në Kryeministri. KM Rama urdhëroi rregulla të reja se çfarë duhet të bënte SPAK përpara këqyrjeve të dokumenteve, si dhe Agaçi urdhëronte sekretarët e përgjithshëm mos ti dorëzonin dokumentet SPAK-ut. Por, deri përpara dy muajve Rama nuk i referohej një çështje konkrete nën hetim nga SPAK. Në dy muajt e fundit KM Rama nga Hoteli Melia, Asambleja e PS dhe një konferencë kombëtare sulmoi SPAK se "sekuestrua preventive" e Bazës Detare të Limionit ishte një veprim absurd dhe se ai po priste lirim dhe bazës. Në fakt SPAK ka kërkuar sekuestron, pasi vendimi është marrë nga tre gjykata, dy GJKKO dhe Gjykata e Lartë.

#### Kthesa e Ramës

Meçollari shprehet se Rama pas sulmeve dhe kërcënimeve ndaj



SPAK fut në panik qeverinë "Rama"

SPAK, në takimin e fundit për të drejtën e informimit, mori në mbrojtje SPAK dhe e falënderoi për punën e mirë që po bëjnë. Shpjegimin e ndryshimeve të tij do të na e japë vetëm SPAK, thotë Meçollari. "Por, në një takim të fundit për të drejtën e informimit KM Rama u shpreh me nota pozitive për SPAK, duke deklaruar se "përfitoj nga rasti të falenderoj dhe të inkurajoj prokurorët e SPAK dhe me shpresë edhe të tjerë në prokuroritë e zakonshme që të bëjnë gjithçka që mundën që ta zvogëlojnë përditë atë pjesën e zezë që është një turp kombëtar, turp shtetëror, turp popullor, turp për të gjithë". Duket qartë se KM është i paqartë lidhur me punën e SPAK. Herë e sulmon publikisht dhe herë e falenderon. Kuptohet, nëse SPAK liron nga "sekuestrua preventive", Bazën Detare të Limionit, KM Rama është konsequent në qëndrimet e tij. Nëse jo, KM Rama ka qëndrime ekstreme, që ndoshta mund të shfaqen më shumë si një "krizë" paniku. Në pamje të parë duken si lajthitje. Gjithsesi, SPAK do të na tregojë të vërtetën. KM Rama është në panik nga SPAK apo në kontroll të SPAK-ut", u shpreh Meçollari.

Ky terror i kryeministrit Edi Rama vjen pasi SPAK i ka çuar gjysmën e qeverisë në burg, si edhe ka hapur dosje për gjysmën tjetër të qeverisë. Madje i rrezikuar është dhe vetë kryeministri, i cili mund "tronditet" nga themelet nëse prokurorët hetojnë siç duhet dosjen e inceneratorëve dhe "McGonigal". Ish-ministri i Shëndetësisë, Ilir Beqaj, ish-ministrja Olta Xhaçka, ish-ministrja e Financave, Shkëlqim Cani; ish-ministrja e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca; ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku; ministrja e Turizmit dhe Mjedisit, Mirela Kumbaro; ish-ministri Damian Gjijnuri duket se janë një hap larg burgut. Të gjithë emrat e sipërpërmendur dyshohet se janë përfshirë në afëra të rënda korruptive dhe kriminale. Dosjet që mbajnë emrat e këtyre socialistëve "VIP", Struktura e Posaçme Kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit po i kopsit një nga një. Rama thotë se ata që kanë ngrënë "dardha pas shpine" të mbajnë përgjegjësi, por nga hetimet e drejtësisë mund të zbulohet se kryeministri mund të ketë ngrënë gjithë pemën.

### Do korruptonin gjyqtarin me 5 mijë euro, GJKKO dënon me 3 vite burg avokatin Arben Lena

Gjykata e Posaçme ka dënuar me 3 vite burg ish kreun e dhomës së avokatisë së Korçës, Arben Lena. Por me gjykim të shkurtuar, Lena është dënuar me dy vite burg. Lena ishte i akuzuar për ushtrim të ndikimit të paligjshëm lidhur me çështjen e një të arrestuari për akuzën e trafikimit të refugjatëve të cilin Lena e mbronte. Avokati ka mohuar akuzat, duke pretenduar se arrestimi i tij është i pabazuar. Sipas Prokurorisë Speciale Arben Lena ishte pjesë e grupit të 5 personave që tentuan të korruptonin me 5 mijë euro gjyqtarët e Apelit të Korçës për të liruar nga paraburgimi Bledar Koziçin, i arrestuar për trafikim refugjatësh. Ndërkohë GJKKO ka dënuar edhe pjesëtarët e tjerë të grupit, së bashku me Bledar Koziçin. Nikolla Hafësllari është dënuar me 1 vit burg. Nikolla Jesku me gjykim të shkurtuar do të vuajë dënimin gjithashtu me 1 vit burg. Për Dajana Kodrën është pezulluar vendimi për ekzekutimi e dënimit me burg dhe do të vuajë dënimin me 2 vite shërbim prove. Sakaq, Dritan Tabaku është shpallur i pafajshëm lidhur me akuzën e moskallëzimit të krimit. Blerand Koziçi është dënuar me 1 vit e 4 muaj burg, ndërsa Artiana Koziçi me 1 vit shërbim prove.

### Dosja Babale, shtyhet në Apel seanca ndaj Salianjit, shkak mungesa e prokurorit të çështjes

Gjykata e Apelit ka njoftuar dje shtyrjen e seancës së parashikuar për ditën e nesërme ndaj deputetit demokrat, Ervin Salianji. Përmes një njoftimi për shtyp Gjykata ka bërë të ditur se seanca për dosjen 'Babale' nuk do të zhvillohet për shkak të mungesës së prokurorit të çështjes. "Në vijim të komunikimeve mbi veprimtarinë e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ju njoftojmë se: Nesër më datë 28.06.2024, ora 10:00, është planifikuar seanca gjyqësore e çështjes penale ndaj të pandehurve Ervin Salianji, etj. Ju komunikojmë se seanca nuk do të zhvillohet, për shkak se prokurori ka depozituar pranë sekretarisë së gjykatës kërkesë për shtyrje seance, duke parashtruar se për arsye objektive nuk mund të jetë i pranishëm. Për seancën e ardhshme do të njoftoheni", thuhet në njoftimin e Gjykatës.

# rajon

## “Kosova është zemra e Serbisë”, provokojnë sërish serbët, ja pse u anulua festivali “Mirëdita, dobar dan” në Beograd

Dje, për arsye sigurie, MPB-ja e Serbisë ndaloi manifestimin “Mirëdita, dobar dan”, e cila promovon bashkëpunimin kulturor ndërmjet Serbisë dhe Kosovës dhe u pasua me protesta të organizatave ekstremiste dhe partive të djathta. Sipas njoftimit për shtyp të zëvendëskryeministrit Ivica Daçiç, ministria e lëshoi ndalimin “për shkak të rrezikut të sigurisë së njerëzve dhe pronës, si dhe rrezikut të prishjes së rendit dhe

qetësisë publike në një zonë më të madhe.” Daçiç ka thënë se në hapësirën e paraparë për ngjarjen nuk do të lejohen tubime të tjera, duke theksuar se për ndalimin janë njoftuar edhe organizatorët e tubimit. Festivali praktikisht as zyrtarisht nuk ka nisur, sepse hapja ishte planifikuar për në mbrëmjen e 27 qershorit në zonën e Dorcol Platz, qendra e ngjarjeve kulturore alternative në kryeqytetin serb. Disa orë para

hapjes, grupe të krahut të djathtë filluan të mbledhen para Dorcol Platz dhe në rrugët fqinje, duke valëvitur flamujt serbë dhe duke brohoritur “Kosova është zemra e Serbisë” dhe emrin e të dënuarit për kriminel luftë Ratko Mlladiç. U dëgjuan këngë nacionaliste dhe mesazhe nënçmuese kundër shqiptarëve të Kosovës, raportuan nga terreni gazetarët e mediave të Beogradit, të cilët theksuan se në këtë zonë ka vetëm

pak policë të trafikut, sepse rruga ku ndodhet Dorcol Platz është mbyllur ndërkohë. Kundër mbajtjes së këtij aktiviteti ishin edhe partitë e djathta parlamentare, me vlerësimin se festivali nuk promovon bashkëpunimin kulturor mes dy popujve, që është axhenda zyrtare e aktivitetit, por “bashkëpunimin mes dy shteteve”, të cilin thonë se “veprimtaria politike organizatorëve është antikushtetuese”.

### Ja propozimi i Andrija Mandić

# Rezoluta për Jasenovacin rrezikon të ardhmen e Malit të Zi, një përgjigje e ashpër pritët nga Kroacia, si fshihet dora e Serbisë pas lëvizjeve të fundit, ja pse miratimi është një “thikë me dy presa” për Podgoricën

Marsela SHYTIA

**K**ryetari i Kuvendit të Malit të Zi Andrija Mandić ka propozuar zyrtarisht dje që propozimi për rezolutën për gjenocidin në Jasenovac të futet në rendin e ditës të seancës së nesërme parlamentare. Propozimi i Mandićit për zgjerimin e agjendës me një rezolutë për Jasenovacin duhet të mbështetet nga 41 nga gjithsej 81 përfaqësues në Parlamentin e Malit të Zi. Opozita malazeze paralajmëroi për synimin e Mandićit për të shfrytëzuar mundësinë e plotësimin të punës së përditshme 24 orë para seancës, duke pohuar se në këtë mënyrë qeveria po përpiket të shmangë një debat publik për rezolutën për Jasenovacin. Me miratimin e saj, Lëvizja populiste “Evropa tani” e kryeministrit Milojk Spajiç duhet të qetësojë dhe kënaq pjesën pro-ruse dhe pro-serbe të strukturës qeverisëse në Mal të Zi, pasi qeveria e tij mbështeti Rezolutën për Srebrenicën në OKB. Rezolutën e nënshkruan edhe zëvendësit e tij.

#### Spajiç i pavendosur

Të mërkurën në Bruksel, Spajiç nuk është përgjigjur konkretisht nëse deputetët e tij do ta mbështesin këtë rezolutë edhe pse janë nënshkruar të saj. Ai u tha gazetarëve se ka më shumë se 40 rezoluta në procedurën parlamentare “për Jasenovacin, për Palestinën, për Shahoviçin (krim-



in kundër boshnjakëve në Mal të Zi) dhe se ka “kohë për këtë pas rezolutës për Srebrenicën që e miratuar bashkërisht në OKB-së”. “Mali i Zi është një vend multietnik dhe multi-konfesional me të gjithë këta përfaqësues në parlament, të cilët tani kanë nevojë për secilin prej këtyre kombeve për të nxitur një rezolutë që është e rëndësishme për trupin e tyre politik ose për kombet ose rajonet të cilave ata i përkasin” ka thënë Spajiç. Ai shtoi se mendon se të këto rezoluta e largojnë Malin e Zi nga disa tema më të rëndësishme.

#### Përgjigjja kroate

Botërore. Ministri Gonxhja u shpreh se në takim palët arritën që të bien në dakordësi për planifikimin e punës që duhet të ecë përpara mes UNESCO-s dhe qeverisë shqiptare, një bashkëpunim që i shërben mirë trashëgimisë kulturore në Shqipëri dhe trashëgimisë botërore. “Ishte një ditë shumë intensive në selinë qendrore të UNESCO-s në Paris, ku me shumë kënaqësi u takuam me nivelin më të lartë të drejtuesve të trashëgimisë botërore dhe ku jemi krenarë si Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit që jemi në sintoni të plotë, një bashkëpunim i shkëlqyer, një programim dhe planifikim shumë i mirë i të gjithë punës që na pret së bashku, në të mirë të trashëgimisë kulturore në Shqipëri dhe trashëgimisë botërore. Dakordësuam një plan pune dhe protokoll shumë të mirë teknik, por edhe politik për të qenë gjithmonë e më afër me njëri-tjetrin, në të gjitha sfidat që na presin për menaxhimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e qëndrueshme të qendrave të trashëgimisë botërore dhe qendrave të trashëgimisë kulturore në Shqipëri”, u shpreh ministri Gonxhja. Ministrja e Mjedisit dhe Turizmit, Mirela Kumbaro tha se pala shqiptare ka shtuar një tjetër dosje në UNESCO, ajo e lumit Vjosa. Ky takim i parapriu sesionit nr. 46 të Komitetit të Trashëgimisë Botërore në New Delhi, Indi, që do të mbahet në datat 21-31 korrik 2024.



Ministri Gonxhja u shpreh se në takim palët arritën që të bien në dakordësi për planifikimin e punës që duhet të ecë përpara mes UNESCO-s dhe qeverisë shqiptare, një bashkëpunim që i shërben mirë trashëgimisë kulturore në Shqipëri dhe trashëgimisë botërore. Dakordësuam një plan pune dhe protokoll shumë të mirë teknik, por edhe politik për të qenë gjithmonë e më afër me njëri-tjetrin, në të gjitha sfidat që na presin për menaxhimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e qëndrueshme të qendrave të trashëgimisë botërore dhe qendrave të trashëgimisë kulturore në Shqipëri”, u shpreh ministri Gonxhja. Ministrja e Mjedisit dhe Turizmit, Mirela Kumbaro tha se pala shqiptare ka shtuar një tjetër dosje në UNESCO, ajo e lumit Vjosa. Ky takim i parapriu sesionit nr. 46 të Komitetit të Trashëgimisë Botërore në New Delhi, Indi, që do të mbahet në datat 21-31 korrik 2024.

## Karnavalet Braziliene vijnë në Lungomaren e Vlorës

■ Karnavalet Braziliene profesor në Vlorë. Në njoftimin për aktivitetet e kësaj jave kulturore, thuhet se karnavalet Braziliene do të zhvillohen në Lungomaren e bukur të Vlorës. “Në një shfaqje të paparë, ky manifestim kulturor do të sjellë ritmin, ngrohtësinë dhe ngjyrat e Brazilit në zemrën e bregdetit. Karnavalet Braziliene do të sjellin për publikun një performancë e mrekullueshme, duke përfshirë perkusionistë të talentuar brazilianë, bale-

rina dhe kërcimtarë profesionistë të disiplinës Capoeira që me lëvizjet e tyre do të na tërheqin në botën ritmike të karnavaleve. Në këtë shfaqje të jashtëzakonshme, nuk mund të mungojë edhe Capoeira, arti i veçantë brazilian i kërcimit luftarak. Kjo disiplinë, paraqet përmes lëvizjeve të kërcimtarëve, akrobacitë dhe lëvizjet e magjishme, që i shtojnë dinamikë dhe bukuri kësaj shfaqjeje ekzotike”, thuhet në njoftim.

## Koncerti i nxënësve të shkollës “Jan Kukuzeli” në amfiteatrin e Durrësit

■ Koncerti i talenteve të reja të shkollës artistike “Jan Kukuzeli” u zhvillua në amfiteatrin e Durrësit. Koncerti erdhi në vijim dhe të aktiviteteve të tjera më parë që janë zhvilluar në amfiteatër. Qendra Muzeore Durrës shprehet se amfiteatri do të vazhdojë të jetë një skenë e hapur, plot aktivitete gjatë gjithë stinës së verës. Amfiteatri i Durrësit, më i madhi dhe më

i rëndësishmi, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Ballkan, është ndërtuar në fillim të shek të II të e.s gjatë sundimit të perandorit Trajan. Ai ka vlera të veçanta arkitekturore dhe artistike dhe mund të krahasohet me monumentet e kësaj periudhe të Pompeit dhe Kapuas në Itali. Amfiteatri ka trajtë elipsi me diametër 136 metra dhe lartësi rreth 20 m.

## Artistët e Teatrit të Kukullave me shfaqje në Rubik


■ Premiera e re “Tre Muskëterët” e Teatrit të Kukullave rrugëtoi drejt Rubikut, duke plotësuar akoma edhe më shumë gjeografinë e turit artistik gjatë sezonit veror. Kjo bëhet me dije nga Teatri i Kukullave që shprehet se shfaqja do të vijojë dhe në skena të tjera për fëmijët. “Kjo shfaqje plot energji gjithë lojës së aktorëve duke dhuruar kënaqësi

fëmijëve të këtij qyteti. Data të tjera, qytete të tjerë, presin për tu argëtuar me shfaqjet e repertorit tonë. Ju presim fëmijë të gëzojmë së bashku”, thuhet nga Teatri i Kukullave, që dhe më parë ka qenë me shfaqjet e tij në qytete të tjera. Në shfaqjet e Teatrit të Kukullave përdoren kukulla me tela, kukulla marionetë, maska, teatro hijesh e pantomima, si dhe shfaqje me aktorë.

## Komisioni i Etikës i UEFA “masakron” me gjoba Shqipërinë

Paraqitja e tifozërisë kuqezi në rrugët dhe stadiumet e Gjermanisë ishte një nga gjërat më të bukura të Europeanit. Kuqezinjtë dushman performancë të kulturuar, ata e kthyen në festë Europeanin dhe tërhoqën vëmendjen e mediave më të mëdha botërore për shkallën e prezantimit të tyre. Por brenda tifozëve pati dhe ndonjë “dele të zezë” prej të cilëve mori jo pak gjoba FSHF. Në fakt, UEFA i ka vendosur federatës tonë gjoba shumë të rënda krahasuar me shkallën e shkeljeve, duke na barazuar me Serbinë në një kohë që tifozëritë e saj brenda e jashtë stadimeve ishin problematike. Kështu, Komisioni i Etikës dhe

Disiplinës në UEFA vendosi të gjobisë për herë të tretë Federatën Shqiptare të Futbollit me vlerën 86,500 euro për incidentet e ndodhura në ndeshjen e raundit të tretë në finalët e Kampionatit European “Gjermani 2024” kundër Spanjës, që u luajt mbrëmjen e së hënës në stadiumin e Dyseldorfit. Ky penalizim financiar ka ardhur edhe këtë herë nga problematikat e shkaktuara nga disa tifozë shqiptarë, të cilët kanë hedhur objekte në fushën e lojës, kanë transmetuar mesazhe të papërshtatshme, kanë ndezur flakadanë gjatë ndeshjes, por edhe për ndërprerjen e ndeshjes nga një tifoz gjatë zhvillimit të lojës. Vendimet e plota të Komisionit të Etikës dhe Disiplinës në UEFA: Të gjobisë Federatën Shqiptare të Futbollit me 8,500 euro për ndezjen e flakadanëve. Të gjobisë Federatën Shqiptare të Futbollit me 25.000 euro për transmetim e mesazheve të papërshtatshme për një ngjarje sportive. Të gjobisë Federatën Shqiptare të Futbollit me 45,000 euro për hedhjen e sendeve. Të gjobisë Federatën Shqiptare të Futbollit me 8,000 euro për pushtimin e fushës. Kjo është gjoba e tretë që UEFA i vendos FSHF-së, teksa është gjobitur edhe në dy ndeshjet e raundeve të para në European, ndaj Italisë (37,375 euro) dhe Kroacisë (47.500 euro), po për të njëjtat arsye.



Mesfushori kuqezi ka vrapuar në tri ndeshjet në grupe plot 37.5 km, si askush tjetër

## Ramadani vë rekord, “maratonomaku” i Europeanit të Gjermanisë

Adriatik BALLA

Shqipëria bëri një futboll të mirë në European, por specialistët mendojnë se mund të bënte më shumë, nisur nga fakti se Shqipëria ka një grup mjaft cilësor lojtarësh, të cilët luajnë në klube të rëndësishme dhe kanë potencial teknik të lartë. Natyrisht, shorti ishte i vështirë për Shqipërinë, pasi ra në grup me tri skuadra që ishin pretendente, si Kroacia, Spanja dhe Italia. Në fakt, Shqipëria u largua me kokën lart nga Euro 2024, ku kishte rënë në “Grupin e Vdekjes” së bashku me Spanjën, Italianë dhe Kroacinë. Kuqezinjtë lanë shenjë në eventin që tashmë ka hyrë në fazat me eliminim direkt me golin më të shpejtë në historinë e Europeanit dhe barazimin epik kundër Kroacisë, që i mbajti në lojë për kualifikimin në ndeshjen e fundit. Një tjetër statistikë e fazës së grupeve bën protagonist një futbollist shqiptar: sipas Transfermarkt, Ylber Ramadani është futbollisti që ka përshkuar më shumë kilometra në tri ndeshjet e para. Mesfushori i Leçes, pikë shumë e rëndësishme e Shqipërisë së Silvinjos, ka vrapuar në total 37.5 km, duke qenë i pakonkurrueshëm në këtë aspekt. Golashënuesi më



i mirë deri tani është sulmuesi i Gjeorgjisë, Mikautadze, me 3 gola, ndërsa dribluese më i mirë francezi Dembele me 22 driblime. Spikat Cristiano Ronaldo në dy aspekte: është lojtari që ka pasur më shumë tentativa drejt portës (12), por edhe ai që është kapur më shumë herë në pozicion jashtë loje (5). Sesko i Sllovenisë është lojtari më i shpejtë, pasi ka arritur shpejtësinë 35.9 km/h, ndërsa Toni Kros i kryeson për numrin total të pasimeve të sakta: 326. Portieri i Gjeorgjisë, Mamedashvili, kryeson me numrit e pritjeve (20), ndërsa mbrojtësi i Sllovenisë, Bijol, është lojtari që e ka spastruar më shumë herë zonën (27).

### Rekordet e tjera të Europeanit, në listë edhe Nedim Bajrami

Një tjetër fazë emocionuese e grupeve të EURO ka përfunduar dhe një numër rekordesh u thyen gjatë aksionit. UEFA ka shkruar një artikull për të gjitha rekordet e thyera dhe aty bie në sy futbollisti i kombëtares shqiptare, Nedim Bajrami, i cili realizoi golin më të shpejtë në histori të Kampionateve Evropiane. Duhet theksuar se Bajrami shënoi golin më të shpejtë në këtë European, të paktën deri tani dhe vështirë se thyhet edhe për shumë vite si rekord, por nisja në atë ndeshje, me gol që në sekondat e para ishte diçka magjike por edhe që nuk solli ndonjë përfitim, pasi

**“Shqipëria bëri një futboll të mirë në European, por specialistët mendojnë se mund të bënte më shumë, nisur nga fakti se Shqipëria ka një grup mjaft cilësor lojtarësh, të cilët luajnë në klube të rëndësishme dhe kanë potencial teknik të lartë....”**

ekipi humbi 2-1 përballë Italisë. Gjithsesi, performanca cilësore e Bajramit në këtë European ka qenë një nga gjërat e mira të Shqipërisë. Ishte padyshim një mesfushor me tipare ofensive që la mbresa në fushën e lojës.

#### Ja rekordet e thyera:

**Goli më i shpejtë në EURO:** Nedim Bajrami (Shqipëri) — 23 sekonda

**Lojtari më i ri ndonjëherë:** Lamine Jamal (Spanjë) — 16 vjeç 338 ditë

**Trajneri më i ri ndonjëherë:** Julian Nagelsman (Gjermani) — 36 vjeç 327 ditë

**Kapiteni më i ri ndonjëherë:** Dominik Szoboszlai (Hungari) — 23 vjeç 243 ditë


**Lojtari më i vjetër ndonjëherë:** Pepe (Portugali) — 41 vjeç 117 ditë

## Futboll femra/ Kosovare Asllani firmos me klubin e ligës së dytë angleze

Në futbollin e femrave po spikasin disa lojtare shqiptare, më të cilat luajnë me klube të njohura europiane dhe madje kanë ndërtuar edhe karrierë të suksesshme, por askush nuk mund të krahasohet me Kosovare Asllanin që ka luajtur me klubet më të mëdha në Europë dhe ka qenë simbol suksesi me përfaqësuesen suedeze. Ndërkohë, në Championship, London

Siti Lioneses, ka siguruar dy ardhje kryesore ndërsa synojnë promovimin në Superligën e vajzave. Lioneses, që përfunduan të tetat në kategorinë e dytë të vajzave sezonin e kaluar, kanë emëruar ish-trajnerin e PSG-së, si dhe lojtaren me prejardhje nga Kosova, Kosovare Asllani. Kjo e fundit, 34 vjeçe, ishte pjesë e ekipit të Suedisë që përfundoi e treta në Kupën e Botës për

vajza 2023 dhe bashkohet me një kontratë dyvjeçare. Lëvizjet vijnë pasi Lioneses u morën nën pronësinë e biznesmenes amerikane Mishel Kang në dhjetor 2023. Klubi gjithashtu ka blerë terrenin e tij të trajnimit, u njoftua, dhe do të luajë ndeshjet e tij sezonin e ardhshëm në stadiumin me kapacitet prej 5,000 vendesh në Hajes Lane. London Siti do të zhvendoset



në Hajes Lane, ku do të ndajnë terrenin me klubin e League Two, Bromley.

### FAKTI

UEFA gjobit Zvicrën edhe për flamurin e UÇK

UEFA e ka gjobitur Federatën e Futbollit të Zvicrës me 28 mijë e 112 euro për shfaqje të flamurit me simbol të UÇK-së gjatë ndeshjes së fundit të grupeve kundër Gjermanisë. Në total Federata e Futbollit e Zvicrës të enjten ka pranuar gjobë rreth 95 mijë euro. Duhet thënë se në radhët e tifozërisë zvicerane ka shumë shqiptarë, për shkak se në radhët e ekipit luajnë yjet si Xherdan Shaqiri e Granit Xhaka, lojtarë që kanë peshë të madhe në përfaqësuesen helvete edhe në këtë Kampionat European.

### SITUATA

Deçiçi shqiptar do ngjyrat kuqezi, acarohen në Mal të Zi

Ngjyrat kuqezi ndezin polemika në Malin e Zi. Klubi i futbollit të Deçiçit, me seli në qytetin e Tuzit, që hyri në histori me fitimin e titullit kampion në vendin fqinj për herë të parë në histori, kanë vendosur të ndryshojnë simbolet e stemës, duke kaluar nga dominimi i blusë me të bardhën, tek e kuqja dhe e zeza. Sigurisht që pjesa më e madhe e komentuesve e kanë mirëpritur këtë iniciativë, duke e quajtur madje edhe të vonuar, por ka edhe nga ata tifozë boshnjakë, që nuk janë dakord me ndryshimin.

### SUPERIORE

Teutës i duhen mbrojtës, por ende s'ka lëvizje

Përparësi në merkaton durr-sake është përforcimi i mbrojtjes, një repart ku Teuta ka vuajtur shumë sezonin e shkuar. Situata u stabilizua disi pas merkatos së janarit, por sërish është e qartë se durr-sakët e kanë të nevojshëm afrimin e lojtarëve mbrojtës. Stafi teknik nuk do që të nxihet për të mos gabuar, por edhe koha në fakt po limitohet, sepse javën e parë të korrikut fillon stërvitja. Trajneri Edi Martini kërkon ta ketë grupin e gatshëm sa më parë. Por lëvizje deri tani nuk ka.

## 5 xhudistë të Kosovës kualifikohen me normë në Olimpiadën e Parisit

Federata Ndërkombëtare e Xhudos (IJF) përmes një letre që ia ka dërguar presidentit të Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi, ka konfirmuar se pesë xhudistë të Kosovës janë të kualifikuar për Olimpiadën e Parisit. Të gjithë janë kualifikuar direkt, që është tjetër tregues se kanë pasur kampanjë të suksesshme kualifikimi. Akil Gjakova është i kualifikuar në kategorinë deri 73 kilogramë, Distria Krasniqi në kategorinë deri 52 kilogramë, Nora Gjakova në kategorinë deri 57 kilogramë, Laura Fazliu në kategorinë deri 63 kilogramë dhe Loriana Kuka në kategorinë deri 78 kilogramë. Të gjithë janë me potencial për medalje

olimpike, që janë më të vlefshmet në sport. "Përgatitjet po shkojnë sipas planit. Deri më tani çdo gjë është në rregull", ka thënë Driton Kuka, trajner i Kosovës në xhudo. Si para çdo gare të madhe, trajneri Kuka është i matur në parashikime. Ai kujdeset që puna të jetë e nivelit më të lartë të mundshëm dhe përkushtimi e serioziteti i sportistëve i duhuri. Kosova i ka tri medalje të arta olimpike. Natyrisht, të tria në xhudo. Në "Rio 2016", Majlinda Kelmendi kishte fituar të artën në kategorinë deri 52 kilogramë. Majlinda tani është trajnerë në stafin e Driton Kukës. Me normë në Rio ishte edhe Nora Gjakova. Në "Tokio

2020", të mbajtur në vitin 2021, medalje të arta fituan Distria Krasniqi në kategorinë deri 48 kilogramë dhe Nora Gjakova në kategorinë deri 57 kilogramë. Me normë në Tokio ishin edhe Majlinda Kelmendi, Akil Gjakova e Loriana Kuka. Sërish Kosova i ka fituar pesë norma, ndërsa Driton Kuka, tashmë ka nisur punën për identifikimin e xhudistëve të rinj dhe përgatitjen e tyre për të "sulmuar" normën për Lojërat Olimpikë 2028. Në të gjitha sportet tjera Kosova e ka vetëm një normë olimpikë. Boksierja Donjeta Sadiku është po ashtu e kualifikuar. Edhe Donjeta vlerësohet pretendente për medalje.



Portieri konsiderohet pikë e fortë e përfaqësueses kuqezi, merr notë të mirë

## Thomas Strakosha në listën me 9 portierët më të mirë të Europeanit

Adriatik BALLA

Shqipëria e mbylli Europeanin e saj, duke u eliminuar që në fazën e grupeve, pasi u ndodh në një short të vështirë me Spanjën, Italinë dhe Kroacinë. Theksojmë se paraqitja e kuqezinjve ishte e mirë, por pa rezultatet e duhura, pasi e mbyllëm në vend të fundit me 1 pikë. Por, kur shihen emrat kë kishim përballë, rezultatet janë të justifikuar. Theksojmë se një nga lojtarët që u paraqit më mirë në këtë European ishte portieri Thomas Strakosha. Nga 5 gola që pësoi ekipi, portieri nuk pati përgjegjësi direkte tek asnjëri, edhe pse në ndonjë rast mund të ishte treguar disi më i shkathët sikurse te goli i parë i Italisë.

### Nota

Portieri italian i Paris SG, Xhianluigi Donaruma, dominon në renditjen e portierëve më të mirë pas fazës së grupeve të Euro 2024. Portieri italian e mbajti Italinë në lojë në të tri ndeshjet, duke luajtur një rol vendimtar në kualifikimin për në 1/8. Evropian i jashtëzakonshëm deri tani për Giorgi Mamardashvili. Vitin e kaluar, gjeorgjiani ishte në shënjestër të Bajernit të Mynihut, i cili po kërkonte një alternativë për Manuel Nojer. Është e vështirë për të që të pranojë një



transferim tani për të qenë rezervë: heroi i play-off-it kundër Greqisë, ku priti një penalti, Mamardashvili ishte gjithmonë në formë, edhe pse në debutimin kundër Turqisë pësoi tre gola. Duke parë paraqitjen e Trubin, ndoshta trajneri ukrainas Sergij Rebrov do të pendohet që nuk e vendosi atë në ndeshjen debutuese kundër Rumanisë, ku Lunin ishte protagonist negativ, pasi kishte faj të veçantë në dy nga tre golat e pësuar. Portieri i Shqipërisë, Thomas Strakosha, renditet i nënti në këtë klasifikim, me notën 6.33, më lart se emra të mëdhenj si Maignan i Francës, Neuer i Gjermanisë apo Szczesny i Polonisë. Pavarësisht eliminimit të kuqezinjve në fazën

e grupeve, me 5 gola të pësuar, Strakosha ka pasur përgjithësisht performancë pozitive, duke kryer disa pritje vendimtare.

### Mesfushori/ Keidi Bare kërkohet nga Olimpiakosi grek

Keidi Bare merr një ofertë nga skuadra më e madhe greke, Olimpiakos. Gazetari spanjoll, Arturo Diath, ka bërë një postim në llogarinë e tij personale në X duke publikuar një lajm të botuar në Greqi mbi interesimin e fituesve në fuqi të Conference League. Ai vuri në dukje se mesfushori qendror shqiptar 26-vjeçar pas 30 qershorit do të jetë lojtar i lirë dhe nuk do të rinovojë kontratën me klubin katalanas, me të cilin fitoi ngjytjen në La Liga. Madje,

ai përmendi se Bare tashmë është në bisedime me Rajo Valekanon, duke nënvizuar se sigurisht që ka edhe oferta të tjera, si Olimpiakos dhe Leganesh. Sezonin e kaluar ai bëri 42 paraqitje, duke dhënë tri asistime në më shumë se 2400 minuta të luajtura. Kujtojmë që Keidi Bare mbeti jashtë listës së Shqipërisë në Euro 2024 për zgjedhje teknike të trajnerit Silvinjo.

### NOTAT E PORTIERËVE PAS FAZËS SË GRUPEVE:

7.67 Donaruma (Itali)
7.17 Mamardashvili (Gjeorgji)
6,75 Trubin (Ukrainë)
6,5 Kastelë (Belgjikë)
6.5 Verbrugen (Holandë)
6.5 Nita (Rumani)
6.5 Oblak (Slloveni)
6.5 Unai Simon (Spanjë)
6.33 Strakosha (Shqipëri)
6.33 Maignan (Francë)
6.33 Nojer (Gjermani)
6,25 Shezni (Poloni)
6.17 Livakoviç (Kroaci)
6.17 Shmeikel (Danimarkë)
6.17 Rajkoviç (Serbi)
6.17 Somer (Zvicër)
6,17 Gulaski (Hungari)
6 Pikford (Angli)
6 Diogo Kosta (Portugali)
6 Gun (Skoci)
6 Dubraka (Sllovakia)
6 Gunok (Turqi)

### UEFA

Ja gjyqtarët për dy ndeshjet e Tiranës me Torpedo Kutaisi

Tirana do të përballet kundër Torpedo Kutaisit në raundin e parë të kualifikueseve të Ligës së Konferencës. Takimi i parë do të zhvillohet me datë 11 korrik në Gjeorgji, ndërsa i kthimit me 18 korrik në Tiranë. UEFA ka zyrtarizuar edhe arbitrat që do të gjykojnë 2 takimet. Në Gjeorgji do të jenë 4 armenë, me kryesor Zaven Hovhansian e ndihmës Kaçatur Hovhansian edhe Gevorg Shakhkaldian. Për ndeshjen e kthimit që do të zhillohet në "Air Albania", janë 4 gjyqtarë çekë, kryesor Dalibor Černi.

### SUPERIORE

Skënderbeu nis blerjet, vijnë dy nigerianët e parë

Skënderbeu mbylli një sezon shumë të mirë, teksa siguroi pjesëmarrjen në "Final 4". Juglindorët duan të jenë edhe më të fortë sezonin e ardhshëm dhe po studiojnë alternativa të ndryshme për t'u përforcuar. Presidenti i ka dhuruar dy lojtarë të rinj teknikut Ivan Gvozdenoviç. Ata janë Chukunyer Emanuel dhe Akoama Gift. Lojtarët nigerianë janë 19 dhe 20 vjeç. Dy afrimet e para të Skënderbeut do të zyrtarizohen javën e ardhshme. Drejtuesit e klubit po punojnë për të tjera përforcime.

### TRAJNERI


E shkatërroi Shqipëria, por Daliç mbetet në krye të Kroacisë

Zlatko Daliç do të vazhdojë të jetë trajner i Kroacisë edhe pas eliminimit nga Kampionati Evropian. Këtë e ka konfirmuar presidenti i Federatës Kroate të Futbollit, Marijan Kustić. "Ai është trajner dhe do të vazhdojë të jetë trajner i kombëtares së Kroacisë. Ne folëm dhe shtrënguam duart. Ai do të qëndrojë", tha Kustić. Kujtojmë që Kroacia me dy pikë të grumbulluara nuk ia doli të kalonte grupet në Euro 2024, pasi ishte bashkë me Shqipërinë, Italinë e Spanjën në "grupin e vdekjes".

## Kalendari i ekipeve shqiptare, Ballkani të martën, Egnatia të enjten

Krahas zhvillimit të ndeshjeve në Kampionatin Evropian, duket se do të ketë duele interesante dhe në Champions, Europa dhe Conference League, aktivitete që nisin brenda javës së ardhshme. Skuadrat shqiptare po vijnë përgatitjet e tyre për pjesëmarrjen në kompeticionet europiane teksa kanë gati edhe axhendën për ndeshjet e para të turit të parë eliminator. Të parat që do të zbresin në fushë janë ekipet që luajnë në Ligën e Kampioneve me Ballkanin me Deçiçin do të zbresin në fushë të martën

për ndeshjet përkatëse në transfertë. Të mërkurën e ka radhën Struga, e pastaj Egnatia e cila luan në Bosnjë në orën 21 të datës 10 korrik ndeshjen e saj të parë historike në Ligën e Kampioneve. Më pas të enjten luhen sfidat e skuadrave pjesëmarrëse në Ligën e Konferencës, duke nisur nga Malisheva që luan në "Zahir Pajaziti" e para në orën 17:00. Më pas e ka radhën Shkëndija, ndërsa me diferencë nga një orë luhen ndeshjet e skuadrave të Superiores. Tirana e nis sfidën e saj në orën 19:00, për



t'u ndjekur nga Partizani në orën 20:00 dhe pastaj Vllaznia në orën 21:00. Kalendari i ndeshjeve të kthimit me oraret përkatëse nuk është zyrtarizuar ende nga UEFA.

# kulturë

## Paris Hilton flet për abuzimet e përjetuara në adoleshencë: Ajo që kam përjetuar ishte çnjerëzore

Paris Hilton bëri thirrje për ndryshim në njësitë e objekteve të banimit për adoleshentët, ku dërgohen për përmirësim të sjelljes dhe ka ndarë eksperiencën e saj që pati me abuzimin kur ishte adoleshente. Ajo këtë e ka bërë përballë një komisionit të Kongresit të SHBA-së, raporton BBC. Hilton ka thënë se i janë dhënë medikamente me forcë dhe ka përjetuar dhunë seksuale nga stafi i objektit

privat të banimit të adoleshentëve ku ishte dërguar të qëndronte. Dëshmia e saj vë dritë mbi institucionet që mbikëqyrin adoleshentët e ashtuquajtur "problematikë", ku përfshihen ato që kanë për synim përmirësimin e sjelljeve të tyre. Ajo tha se mendon se objektet rinore duhet të jenë më shumë nën vëzhgim. "Ajo që kam përjetuar ishte çnjerëzore. Për shkak të kësaj, kam trauma dhe do t'i kem

për pjesën tjetër të jetës sime", tha Hilton. Paris Hilton më parë ka folur për traumën që ka përjetuar kur u dërgua në njërin nga këto njësi kur ishte 16 vjeç dhe prindërit e saj filluan të shqetësoheshin për sjelljen e saj. Tani ajo po u kërkoi ligjvënësve amerikanë të miratojnë një projektligj të quajtur "Stop Institucional Child Abuse Act" (Akti për Ndalimin e Abuzimit Institucional me Fëmijët).



### FJALEKRYQI SOT

1	2	3		4	5	6		7	8	9	10		11
12			13					14					
15			16				17					18	
		19				20					21		
	22				23					24			
25				26					27				
28			29					30					31
32			33					34					35
		36						37				38	
39						40					41		

### HORIZONTAL

1- Masë drithi që nxë 40 kg 4- I vogli i pelës 7- Me të meta fizike 12- Tani, në dialektin e Elbasanit 13- "Qeveria" e fshatit 14- Njeri i mefshtë, që s'para mbush 15- Një e njëmijta pjesë e milimetrit 17- Një ekip futbollit italian 18- Kompozitori Maskanji në indic 19- Edmondi, shkrimtar, publicist, përkthyes, në indic 20- Ndryshe për mbledhje 21- Thirrje e tifozëve në stadium 22- Tip veture ruse 23- Diçka e ngjashme me një tjetër, mostër 24- Fshat shumë afër Tiranës, në veri 25- Është material inert 26- Veshja dimërore e ushtarit 27- E takon pak diku 28- Një nënë nga Gjirokastra 29- Mikael..., ish futbollist gjerman 30- Ish aktori Karma 32- Pjetër Arbërori 33- Drejtues Partie 34- Shëtit 36- Cak, kufi, apo ... 37- Kundron diçka, e shikon me ëndje 38- Organizatë terroriste në Irlandë 39- Lumi i Gjirokastrës 40- Këngë solemne që i kushtohet atdheut dhe flamurit 41- Është filozofia e moralit, që përcakton normat e sjelljes, i pashquar.

### VERTIKAL

1- Fije floku 2- "Bel...", roman nga Mopasani 3- Njeri që shkëput lidhjet me masa, mbyllje brenda interesave të ngushta të një grupi, shumë 4- Shkuan, dialektore 5- Fringo fare, i sapo dalë nga fabrika 6- Pohojnë italianët 7- Myrtja, personazh tek filmi "Kur hidheshin themelet" 8- Ai drejton një manastir 9- Robin..., ish futbollist i Manchester-it 10- Automjetet e Shqipërisë 11- Brun 13- Ish akademiku Ylli... 14- I thonë edhe çitjane apo brekushe, vishen nga gratë çame 16- Dele me lesh të dredhur 17- Kafshë shtëpiake mashkull 18- I moshuar 20- Është perde në teatër 21- Pajisjet prej druri të shtëpisë 22- I prodhojnë drurët e dushkut, janë ushqim për bagëtinë dhe sidomos i pëlqen ariut 23- Art i të kërcyerit me figura në skenë 24- Josip ... Tito 25- Një ekip futbollit i Vjenës 26- Një qytet bregdetar në jug të Spanjës, pothuajse në brigjet e Gjibraltarit 27- Shkencëtari francez ... Kyri 29- Ish futbollisti i Tiranës Arjan ... 30- ... Bue Shpata, patriot dhe fisnik shqiptar nga dera e Shpatajve 31- Shkencëtari anglez Newton 33- Fshat turistik buzë Ohrit 34- Filiz i njomë që del nga trunghi i pemës 35- Njëloj si nr.5 vertikalisht 36- Literaturë Italiane 37- Sytë, përgjysmë.

### SUDOKU

5		1	4		6	2		8	3	5					2	1	5	3		9	2	7				
4								9	1		9		8			3			7		5					
			7	2	3					6		3		5						3		5				
	8	7				6	1			9		6	1	4		5			9							
9			2		1			5									3			5	1	4		2		
	5	2				4	9			4		3	7	2		8							8			
			3	8	5						3		8		4				1			8				
7								6	8		4		3			9				6			2			
2		5	6		4	3		1	9	6						3	8			4		9	3		6	5

### Bill Cobbs vdes në moshën 90-vjeçare

Aktori i njohur Bill Cobbs me role në filma sikurse "Night at the Museum" dhe "The Bodyguard" vdiq në moshën 90-vjeçare. Një nga anëtarët e familjes së Cobbs shkroi në rrjetin social Facebook se aktori vdiq "i qetë" në shtëpinë e tij në Kaliforni të martën. TMZ ishte i pari që raportoi për vdekjen e tij. "Një partner i dashur, vëlla i madh, xhaxha, prind zëvendësues, kumbar dhe mik, Bill së fundmi dhe i lumtur festoi ditëlindjen e tij të 90-të i rrethuar nga të dashurit e tij", shkroi familja e tij në mesazh. "Si familje ne ngushëllohem duke ditur që Bill ka gjetur paqe dhe prehje të përjetshme me Atin e tij Qiellor. Ne kërkojmë lutjet dhe inkurajimin tuaj gjatë kësaj kohe", thuhet më tej në mesazhin nga familja. Karriera e Cobbs u shënuar me afro 200 role në filma dhe televizion.



### Biseda për telefonin

Dy gra pasi kanë mbaruar punët e shtëpisë ulen, bisedojnë me njëra-tjetrën për problemet dhe hallet e ditës. Një problem shumë i madh për njërin prej tyre është fatura e majme e telefonit. Ajo i thotë shoqes:

- Jam shumë e mërziur, sepse më ka ardhur fatura e telefonit shumë.

Shoqja që i përgjigjet:

- E moj se nuk është ndonjë gjë e rëndë, se edhe mua ma ka ndodhur diçka e tillë dhe e kam kaluar. Sa tragjike që e bën edhe ti.

Gruaja e parë i thotë sërisht:

- Po unë nuk kam fare telefon.

### Fshatari dhe djali

Një fshatar thërret një djalë të ri dhe i thotë:

- Merre stolin dhe shko për të mjelë lopën.

Kalon një orë, dy, tre, katër. Pas pesë orësh kthehet djali i gjithi i djersitur, por me kovën bosh dhe me stolin në dorë, dhe i thotë fshatarit:

- Zotëri, kam pesë orë që po përpiqem, por lopa nuk ka ndërmend të ulet tek stoli, që mora prej jush.

# kulturë

Në një autostradë të Kalifornisë u derdhën tetë tonë avokado. Kamioni që po i transportonte u përmbys në autostradën 101 në San Mateo dhe ngarkesa iu derdh në orët e para të mëngjesit. Në aksident janë përfshirë dy automjete të tjera, por nuk është raportuar për lëndime, ka shkruar Upi. Autoriteteve rrugore iu janë dashur disa orë për të hequr kamionin dhe për të pastruar rrugën. Rruga që u bllokua nga avokadot u hap dikur vonë.

## Kamioni që u përmbys me avokado bllokoi rrugën në Kaliforni



### Përgjigjet e fjalëkryqit

D	R	O	G	A		O	M	A	N	I
H		P	I	R	A	M	I	D		M
U	P		R	A	K	E	T		K	O
N	U	N		T	E	L		T	A	L
A	N	A	L		R	E	T	I	N	A
	E	S	A	T		T	O	R	A	
S	T	E	P	A	1/T		K	A	R	A
K	O	R		T	9/O	K		N	I	K
I	R		K	I	11/N	I	N		N	O
L		K	O	M	2/I	T	E	T		M
E	L	I	T	E		A	R	E	N	A

### Google Translate zgjerohet me gjuhë të reja

Google Translate ka thyer barrierat gjuhësore, duke i ndihmuar njerëzit të lidhen dhe të kuptojnë më mirë botën. Me përparimet teknologjike, Google ka zgjeruar në mënyrë të qëndrueshme aftësitë gjuhësore. Tani, ndërsa AI është në qendër të vëmendjes, kompania po e përdor atë për të diversifikuar edhe më tej gjuhët e disponueshme në aplikacion. Siç raportohet, gjiganti i teknologjisë po prezanton 110 gjuhë të reja në Google Translate, duke shënuar zgjerimin më të madh deri më sot, shkruajnë mediat e huaja. Kjo arritje është bërë e mundur nga modeli i gjuhës PaLM 2, të cilin Google e vlerëson si thelbësore për të mundur që Translate të mësojë në mënyrë efektive.

### Fjalëkryq i shifruar

1	15	4	8	1		4	12	7	11	1
2		12	4	2	7	12	10	2		16
10	13		11	10	2	7	11		3	1
6	14	2		6	7	11		3	4	2
1	2	4	9		3	4	6	1	9	7
	7	6	1	6		12	10	11	1	
1	6	1	12	10	2/R		8	1	12	7
6	4	12		12	7/I	6		12	10	11
7	12		6	7	11/K	4	8		2	10
12		8	1	16	1/A	6	1	9		9
1	11	7	8	7		1	11	10	6	1

1			2	3		4	5			6
			7		8					
			9						10	
11	12			13				14	15	
16			17				18			
	19					20				
21					22					
23				24						25
26			27						28	
		29						30		
	31						32			
33						34				
35					36		37			38
39				40		41		42		
		43	44				45			
			46							
47							48			

### HORIZONTAL

1- I thonë edhe korije, vend me drurë e shkurre të dendura 4- Model i një veprë në shkallë të zvogëluar 7-Vërshim i popullit në shesh 9- Qytezë në rrethin e Elbasanit 11- Fringo fare, e sapodalë nga fabrika 13-tani, me dialekt 14- Faraa e këngës 16- Shkencëtarja franceze Kyri me origjinë polake 18- Një prift françeskan 19- Ish-portieri i përfaqësueses italiane Zof 20- ai është miku më i mirë i njeriut 21- Ish-futbollisti brazilian Rikardo ..., ka luajtur me realin 22- Vend poshtë shtëpisë ku rrinte më parë bagëtia 23- Organizatë terroriste në Irlandë 24- Është fshat i Vlorës 26- Hyrja në verandë 27- Sëmundje e rëndë e mushkërive 28- notë muzikore 29- I thuhet edhe uror, copë çeliku për të ndezur eshkën 30- Kësulë prej cohe zakonisht e kuqe që mbajnë disa banorë të Lindjes së Mesme 31- Shenjë matematike për këndet 32- Qytet bregdetar në jug të Italisë 33- Dëshmori i parë ... Laçi 34- Kongoli i muzikës 35- ... Mysliu, kryeinxhinier në ndërtimin e disa hidrocentraleve dhe ministër 37- Një shenjë e horoskopit 39- Automjetet e transportit ndërkombëtar 40- ... Qinari te filmi "Komisari Dritës" 42- Vilhelm ... Heroi Kombëtar i Zvicrës 43- Dolorëes ..., politikane spanjolle me origjinë baske, mori pjesë në luftën e Spanjës 46-Një shtet arabik me kryeqytet Muskat 47- Spiropali e PS, ministre 48- Është grimcë elementare, i shquar.

### VERTIKAL

1- Njëlloj si dhënie fjale 2- Organizatë terroriste baske 3- Kuçedër 4- Heroina Peza 5- Autoritetet Minoritare Omonio 6- Regjisori Esat ... 8- Ish-futbollisti i Tiranës Arjan ... 9- Gjini e letërsisë artistike me vepra poetike 10- Ekipi i futbollit të Pukës 12- Aparatë për zbulimin e objekteve në natyrë 15- Stavri ... tek filmi "Vitet e para" 17- Gjika e skenës 18- Përfitim 20- Djall, shejtan 21- Një frutë mesdhetar 22- Lloj peshku liqeni me shumë hala 24- Takije prej cohe që mbajnë myzeqarët në kokë 25- Virna ... aktore italiane 27- Romani "Vanina ..." nga Stendal 28- Shkrimtari spanjoll Prosper ... autor i Karmen 29- Emri i mëparshëm i Egjiptit 30- Ish-futbollisti italian Xhaçinto 31- ... Khedira, futbollist gjerman te Juvja 32- ... Spencer 33- Automjetet i vogël familjar 36- Filmi artistik "... e ngrohtë" 38- Kështu quhej më parë vendi ynë 40- "... Pik" një opera e Çajkovskit 41- Janë kodra prej rëre në shkretëtirë 44- Shumë i pasur 45- Ka edhe një të tillë fetar.

### HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI

**Dashi**  
21 mars - 20 prill  
Do keni ndryshime të shpeshta humori gjatë kësaj dite dhe do ndryshoni mendim nga një moment në tjetrin.

**Demi**  
21 prill - 21 maj  
Në punë do iu jepet mundësia të rregulloni çdo gjë. Marrëdhënia me kolegët do jetë më e mirë dhe do mbështesni njëri-tjetrin.

**Binjakët**  
22 maj - 21 qershor  
Në planin financiar do jetë një ditë mjaft pozitive. Plutoni do iu nxitë ta menaxhoni me kujdes buxhetin.

**Gaforrja**  
22 qershor - 22 korrik  
Nuk do jeni në humor sot dhe herë pas here do jenë emocionet negative ato që do mbizotërojnë. Kujdes me çdo hap që do hidhni.

**Luani**  
23 korrik - 22 gusht  
Ditë përgjithësisht e qetë dhe pa probleme pritet të vijë. Pasdite mirë do ishte të bënit një bilanc të gjithçkaje.

**Virgjëresha**  
22 gusht - 22 shtator  
Paqëndrueshmëria e Neptunit mund të sjellë edhe tronditje në jetën tuaj sot. Intuita mund t'iu çojë në rrugë të gabuar.

### HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI

**Peshorja**  
23 shtator - 22 tetor  
Jupiteri do iu mbrojë në planin financiar, ndërsa Urani dhe Neptuni do iu sjellin më tepër fat. Përfitoni nga kjo ditë.

**Akrepi**  
23 tetor - 21 nëntor  
Gjatë kësaj dite të javës do jeni shumë të kujdesshëm për të ruajtur një klimë harmonike kudo.

**Shigjetari**  
22 nëntor - 21 dhjetor  
Financat nuk do jenë të këqija, por gjithsesi nuk duhet të merrni vendime të rëndësishme që kërkojnë edhe goxha buxhet.

**Bricjapi**  
22 dhjetor - 21 janar  
Në sektorin financiar do keni probleme goxha të mëdha. Me pak fjalë do korrni atë që keni mbjellë.

**Ujori**  
22 janar - 19 shkurt  
Në planin financiar, aftësitë tuaja do iu ndihmojnë të ruani një ekuilibër. Do shmangni edhe shpenzimet e mëdha.

**Peshqit**  
20 shkurt - 20 mars  
Gjatë kësaj dite, nën ndikimin e Marsit do ktheni disa faqe të librit të jetës dhe do hapni disa të tjera.

# Befasitë e Europeanit të Gjermanisë, listës së golave i prin një gjeorgjian

Gjeorgjia i kaloi pritshmëritë e saj në Euro-2024, duke kaluar grupin si e treta më e mirë, pasi korri një superfitore ndaj Portugalisë me shifrat 2-0

Adriatik BALLA

**E**uropiani ka regjistruar disa rekorde këtë edicion, në fazën e grupeve, ku në listë ka dhe lojtarë shqiptarë si Bajrami, Ramadani e Strakosha. Por duket se surpriza më e madhe e këtij Europeani është Gjeorgjia, skuadër e cila para nisjes së kampionatit llogaritej si më e dobëta. Në fakt, Gjeorgjia u kualifikua në grupin F, duke shkuar më tej si vendi i tretë më i mirë. Ndërkohë, Xheorxh Mikautadze është sulmuesi më i mirë i fazës së grupeve të Euro 2024. Gjeorgjiani vjen nga një vit për t'u harruar për sa u përket paraqitjeve dhe rezultateve. Pas gjashtë muajsh tek Ajaksi, ku lamtumira e tij u pa si një çlirim nga tifozët, kaloi gjashtë muaj të tjerë te Metz, ku pavarësisht se bëri shumë mirë, nuk arriti të shmangë rënien e ekipit të tij. Ku do ta shohim pas këtij turneu? Diçka me siguri do të lëvizë për sa i përket



tregut. Niko Uilliams është sensacioni i Spanjës, që ka shkëlqyer deri tani, dhe nuk është rastësi që klubet angleze po kthehen me vendosmëri drejt anësorit të Bilbaos, që ndryshe nga vëllai i tij, që zgjodhi të përfaqësojë Ganën, është vënë në dispozicion të vendit ku ka lindur. Ndoje nga Bolonja ka bërë shumë mirë, është në formë fantastike dhe një nga lojtarët më

të rrezikshëm në ndeshjen Zvicër-Itali. Mungojnë deri më tani Kilian Mbape, Herri Kejn, Kristiano Ronaldo dhe Romelu Lukaku. Një nga futbollistët më të mirë në performancën e Gjeorgjisë në këtë European është Kviça Kvaratskhelia, që ndaj Portugalisë bëri një super paraqitje. Momenti i veçantë, i fiksuar edhe nga kamerat e UEFA-s, në përfundim të takimit

mes Portugalisë dhe Gjeorgjisë, në raundit e tretë të ndeshjeve në grupe, e përfunduar 2-0 për gjeorgjianët. Sa gjyqtari vërsheleu për përfundimin e takimit, i gjithë stoli i Gjeorgjisë shpërtheu nga gëzimi dhe u nis drejt fushës për festuar me pjesën tjetër të skuadrës, ndërsa "ylli" i Napolit, Khviça Kvaratskhelia, pas nxitimit të momentit, si të gjithë shokët e tij, u ndal dhe iu afrua Kristiano Ronaldos, me të cilin shkëmbeu disa fjalë. Me siguri, lojtari më i mirë i Gjeorgjisë ka marrë përgëzime nga CR7, por edhe ka prenotuar fanellën e tij, pasi para ndeshjes ishte shprehur: "Unë nuk jam në ankth. Por kjo është diçka për të cilën kam ëndërruar, duke luajtur kundër Ronaldos. Ronaldo nuk luan më në Evropë, por ai është në grupin tonë dhe ndonjëherë ëndrrat bëhen realitet. Shpresoj të dal nga kjo ndeshje me fanellën e Ronaldos, shpresoj që ai ta ma japë mua".

## Surpriza/ Ivanishvili premio 10 mln euro për kualifikimin e Gjeorgjisë

Një nga surprizat e bukura të këtij Europeani ishte padyshim Gjeorgjia. Ndërkohë, vlerësimi për ekipin po rritet. Themeluesi i partisë në pushtet i Gjeorgjisë, miliarderi dhe ish-kryeministri i Gjeorgjisë, Bidzina Ivanishvili, ka thënë të enjten se do t'i japë donacion afro 10 milionë euro për përfaqësuesen gjeorgjiane pas fitores ndaj Portugalisë. Me fitoren 2:0 ndaj portugezëve, gjeorgjianët u kualifikuan në fazën

nokaut të "Euro 2024". Në një komunikatë për media, partia e tij, "Ëndrra Gjeorgjiane", ka thënë se Ivanishvili e ka uruar ekipin dhe i ka premtuar paratë nga fondacioni i tij bamirës, për arritjen të cilën ai e ka quajtur "fitore ëndërrash dhe historike". Ivanishvili, pasuria e të cilit është rreth 5 miliardë euro, ka premtuar edhe 10 milionë euro tjera nëse Gjeorgjia e mposht Spanjën në 1/8 e finales të dielën.



### DEKLARATA

**Bonxhorno: Spaleti po e forcon Italinë**



Dueli i parë i së shtunës, ai mes Zvicrës dhe Italisë, sheh një përfaqësues italianë të sulmuar nga mediat dhe kritikët. Por, nisur nga qëndrimi i futbollistëve dhe disa segmente të ndryshme në televizion, me opinionistë e trajnerë, thonë se trajneri Spaleti po punon mirë. Ndërkohë, mbrojtësi i Italisë, Alesandro Buonxhiorno, ka bërë të ditur se ka mbetur i

befasuar me selektorin Luçiano Spaleti, pasi sipas tij, ai të gjithë po i ndihmon për t'u rritur si futbollistë në aspektin individual dhe ekipor. Buonxhiorno ishte i pranishëm në konferencën për shtyp të enjten dhe është pyetur për Spaletin. "Dëshira e tij është për t'ia kuptuar idetë. Ai është i fokusuar në secilën stërvitje dhe në çdo gjë që ne bëjmë. Ai

është i fokusuar në taktika, po ashtu. Si ta mposhtim presingun e kundërshtarit dhe si të bëjmë ne presion. Unë jam rritur shumë si lojtar. Kjo më ka befasuar sepse ai po na rritë të gjithëve si ekip", ka thënë Buonxhiorno të enjten. Qendërmbrojtësi i Torinos pritet të luajë në ndeshjen kundër Zvicrës, në mungesë të Rikardo Kalafiorit, mungesë e rëndësishme e Italisë.

**NJOFTIM**  
Agjencia e Lajmeve



kërkon

- gazetarë webi dhe
- grafik dizajner

Kontakti në adresën:  
gazetasot@yahoo.com  
gazetasotnews@gmail.com

### SITUATA

**Zvicrës do t'i mungojë një lojtar i rëndësishëm kundër Italisë**

■ Ndeshjet me eliminim direkt në 1/8 e finales do të kthehen ditën e shtunë më 29 qershor. Dueli i parë në radhës është ai mes Zvicrës dhe Italisë. Në fakt, Zvicra nuk do të ketë Silvan Vidmer në dispozicion për ndeshjen e së shtunës kundër Italisë. Lojtari nuk do të jetë në dispozicion të trajnerit, Murat Jakin dhe në këtë rast ai do të rikthehet në çerekfinale nëse kombëtarja e Zvicrës kalon raundin. Kujtojmë se faza 1/16 e finaleve fillon të



shtunën me ndeshjen mes Italisë dhe Zvicrës nga ora 18:00, një ndeshje ku italianët llogaritet se do ta kenë të vështirë.

### FAKTI

**Kristiano Ronaldos iu prish magjia, asnjë gol në grupe**

■ Sa herë përmenden rekordet në futboll, në mendje bie emri i Kristiano Ronaldos. Sidomos, kur fjala është për kampionate europiane, pasi aty Ronaldo është kryefjala, duke pasur më së shumti gola dhe asiste në të gjithë historinë e EURO-s. Mirëpo, kësaj here Kristiano Ronaldo ka "thyer" një rekord negativ. Për herë të parë në karrierën e tij, Ronaldo dështoi të shënojë në fazë të grupeve të një turneu madhor. Ai nuk arriti të gjejë rrugën



e rrjetës në tri ndeshjet ndaj Çekisë, Turqisë e Gjeorgjisë. Në Europeanët e Botërorët e shkuar ka shënuar në grupe.

**STAFI/**

**DREJTOR/** Arjan PRODANI;  
**ZV/KRYEREDAKTOR:** Elmas BOGDANI;

**KRYEREDAKTOR/** Rigels SELIMANI; (067 5000 200)  
**KULTURË/** Julia VRAPI; **SPORT/** Adriatik BALLA; **MENAXHER SHITJE/** Shpëtim Caco

**MARKETING:** Glen PRODANI (Cel: 068 60 33 098);  
email: gazetasotnews@gmail.com